



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCE

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE
“Incineratori i Tiranës”



RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE **“Incineratori i Tiranës”**

Janar 2022

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 1142/18 prot., datë 10.05.2021.

Faza studimore e auditimit nisi në datë 12.11.2020 me shkresën për njoftim fillim auditimi nr. 1142 prot.; nr. 1142/1 prot., nr. 1142/2 prot. dhe përfundoi më datë 10.05.2021.

Faza e terrenit të auditimit nisi në datë 10.05.2021 me Programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi në 10.06.2021.

Projektraporti i auditimit mori formë përfundimtare më 20.12.2021 dhe me shkresat nr. 1142/19 prot., nr.1142/20 prot., nr. 1142/21 prot. dhe iu përcoll subjekteve nën auditim, respektivisht: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkia Tiranë.

Pas tejkalimit të afatit për observacione nga palët e interesit, subjektet e audituara, konkretisht: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë jashtë afatit 30 ditë kalendarike pas marrjes së projektraportit, kanë paraqitur komentet e tyre.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka paraqitur observacionet e saj mbi projektraportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr. 1142/22 prot., datë 21.01.2022; Bashkia Tiranë ka paraqitur observacionet e saj mbi projektraportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr. 1142/23 prot., datë 25.01.2022; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në e-mail e datës 20.01.2022 referuar situatës pandemike dhe nevojën që ka patur edhe stafi dhe lidershpi i ri i MTM-së për t'u njohur me këtë çështje, ka kërkuar shtyrje të afatit të paraqitjes së observacioneve me 3 ditë punë, por edhe pas këtij afatit MTM ka tejkaluar afatin, duke paraqitur observacionet e saj mbi projektraportin e auditimit nëpërmjet shkresës nr. 1142/24 prot., datë 31.01.2022.

Grupi i auditimit shqyrtoi me vëmendje argumentimet dhe komentet e subjekteve dhe i reflekttoi ato në raportin përfundimtar.

Auditimi është kryer nga grupi i auditimit:

1. M. B., Përgjegjëse e grupit të auditimit;
2. R. K., Anëtare;
3. K. A., Anëtar;
4. A. Gj., Anëtar.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Kontrollit të Cilësisë dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.

PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	6
1.1 Konteksti i problemit social.....	6
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	7
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	8
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	8
2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim	10
2.2.1 Kriteret audituese	10
2.2.1.1 Kriteret e politikës	10
2.2.1.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit	10
2.2.1.3 Kriteret teknike.....	10
2.2.1.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira	11
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	11
2.4 Pësja në buxhet dhe PBB.....	12
2.5 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore	14
3. DETAJET E AUDITIMIT	15
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	15
3.2 Objektivat e auditimit	15
3.3 Pyetjet e auditimit	15
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....	16
4.1 A ka qenë efektive procedura e vendimmarrjes?	17
4.1.1 A ka qenë i mbështetur në kuadrin rregullator dhe strategjik planifikimi i këtij investimi?	17
4.1.2 A ka qenë i dakordësuar nga të gjitha palët e përfshira realizimi i këtij investimi?	24
4.2 A janë marrë masat e nevojshme për të siguruar eficiencën e projektit?	36
4.2.1 A është zbatuar procedura e duhur e konkurrimit për këtë investim?	36
4.2.2 A janë përmbushur detyrimet e kontratës koncesionare deri në momentin e auditimit? ..	38
5. PËRMBLEDHJA.....	50
6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE	54

LISTA E TABELAVE

TABELA 1 - VLERA E INVESTIMIT KONCESIONAR SIPAS SEKTORËVE (NË MIJË LEKË)	12
TABELA 2 - VLERA E INVESTIMEVE KONCESIONARE NË MJEDIS NË RAPORT ME PBB-NË (NË LEKË) ..	13
TABELA 3 - BUXHETI PLAN DHE FAKT I BASHKISË TIRANË PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE (NË LEKË)	13
TABELA 4 - BUXHETI PLAN DHE FAKT PROJEKTIT TË INCINERIMIT DHE REHABILITIM I LANDFILLIT TË SHARRËS (NË LEKË).....	14
TABELA 5 - AVANTAZHET DHE DISAVANTAZHET E INCINERIMIT.....	19
TABELA 6 - KONTRATAT E PASTRIMIT TË MBETJEVE URBANE PËR BASHKINË TIRANË	42
TABELA 7 - SHEPNZIMET E BT PËR PASTRIMIN DHE DEPOZITIMIN E MBETJEVE URBANE NË LANDFILL	42

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1 ñ HARTA E PËRGJEGJËSIVE TË STRUKTURAVE TË PËRFSHIRA	8
FIGURA 2 ñ ORGANIGRAMA E PJESSHME MTM	9
FIGURA 3 ñ ORGANIGRAMA E PJESSHME MIE.....	9
FIGURA 4 ñ ORGANIGRAMA E PJESSHME E BASHKISË TIRANË	9
FIGURA 5 - SHPËRNDARJA E KONCESIONEVE SIPAS SEKTORËVE (NË %).....	13
FIGURA 7 ñ ANALIZA PESTLE.....	15
FIGURA 8 ñ LANDFILLI I SHARRËS PËRPARA REHABILITIMIT	17

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	ñ Kontrolli i Lartë i Shtetit
ISSAI	ñ Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>International Standards of Supreme Audit Institutions</i>)
INTOSAI	ñ Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
SWOT	ñ Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet (<i>Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats</i>)
VKM	ñ Vendim i Këshillit të Ministrave
NJQV	– Njësitë e Qeverisjes Vendore
BE	– Bashkimi Evropian
MTM	– Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MIE	– Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NJZP	– Njësia e Zbatimit të Projektit

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka pasur një përparim të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, problemi më i madh në administrimin e mbetjeve në Shqipëri nuk qëndron te mungesa e ligjeve, por te mungesa e planifikimit të qartë dhe sipas nevojave në administrimin e këtij sektori, mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit të palëve të përfshira për këtë qëllim, mangësitë në tregues dhe statistika të sakta mbi çështjen e mbetjeve, si dhe mungesë monitorimi dhe rezultatesh të këtij procesi në funksion të vendimmarrjes në vijim. Referuar kuadrit ligjor, Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011 ËPër menaxhimin e integruar të mbetjeveË përcakton se menaxhimi i integruar i mbetjeve bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme:

- a) parandalimin e mbetjeve;
- b) përgatitjen për ripërdorim;
- c) riciklimin;
- ç) rikuperime të tjera;
- d) asgjësimin.

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve, e cila është edhe në përputhje me Direktivat e BE, e thekson në mënyrë të qartë faktin që asgjësimi është mënyra e fundit për t'iu përdorur, dhe mund të përdoret vetëm në rastet kur mënyrat e tjera të hierarkisë nuk mund të jenë të zbatueshme. Asgjësimi është faza më pak e dëshirueshme e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve për arsye se nëpërmjet asgjësimit humbasin vlerat e materialeve. Kjo hierarki duhet të reflektohet në vendimin për investimet që duhet të bëhen. Investimet në landfillet e reja (e cila është faza e fundit e hierarkisë) duhet të bëhen vetëm pasi janë bërë investimet për fazat që ndodhen në fillim të listës së hierarkisë, siç janë infrastruktura e grumbullimit të ndarë të mbetjeve, ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi. Kjo gjë bën të mundur që investimet e reja në landfill të reflektojnë nevojat reale aktuale të vendit, të cilat do të jenë shumë të ulëta në të ardhmen si rrjedhojë e zbatimit dhe detyrimit të fazave të para të hierarkisë. Qëllimi thelbësor i të gjitha rregulloreve mbi mbetjet është mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe e mjedisit nga efektet e dëmshme që shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, përpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuadër mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja është një burim i lëndës së parë (dhe jo dëbë që duhet shpërbërë sa më lirë që të jetë e mundur), kështu që duhet të merren masa për të ripërdorur mbetjet sa më shumë të jetë e mundur. Për sa i përket riciklimit, SKZHI-II paraqet një objektiv mjedisor që është 55% e masës totale të mbetjeve të ripërdoret apo riciklohet, deri në 2020¹ Kjo gjë siguron, gjithashtu, që të mos bëhen investime të panevojshme, por, gjithashtu, edhe kursehet hapësira dhe të shmangen impaktet e panevojshme në mjedis.² Në vitin 2017, moment kur nga Ministria e Mjedisit u konkretizua investimi për Incineratorin e tretë në vend, Eurostat e rendit Shqipërinë të tretën në listën e atyre pak vendeve europiane që përdorin metodën e incenerimit për përpunimin e mbetjeve, pas Gjermanisë dhe Sllovenisë. Ky proces mbulon djegien e mbeturinave ku qëllimi kryesor i djegies është trajtimi termik i mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet vëllimi dhe rrezikshmëria e mbeturinave dhe të merret një produkt inerte. Përfitimi i energjisë përmes incenerimit apo landfillet janë opsionet më pak të preferueshme për mbetjet. Organizata Botërore e Shëndetit vlerëson se gjatë djegies çlirohen dioksina që kanë një sërë efektesh toksikë në trupin e njeriut dhe klasifikohen si kancerogjene. Ato mund të japin efekt edhe tek pjesa hormonale dhe imune në trup. Për sa më lart, por referuar edhe faktit se Shqipëria është renditur mes vendeve që

¹ <http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

² Strategjia Kombëtare dhe Plan i Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve

kanë një nivel të ulët të mbetjeve për frymë në Europë³, lind shqetësimi nëse ky investim është i nevojshëm dhe mund të përballohet në këto kapacitete dhe nëse është i duhuri nga të gjithë hallkat e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve të cituara më lart. Në këtë kuadër theksojmë edhe faktin se gjatë të gjithë procesit të vendimmarrjes lidhur me këtë investim, i gjithë diskutimi ndërmjet palëve të përfshira fokusohet në aspektin financiar dhe pothuajse aspak në aspektin mjedisor dhe efekteve që do të ketë ky investim në mjedis.

Po kështu, referuar Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve, objektivat kryesore të saj lidhen me parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, me kushtin primar të ndarjes së tyre në burim. Megjithatë, siç u theksua dhe më lart, problemi me menaxhimin e mbetjeve në vendin tonë nuk lidhet me ekzistencën e kuadrit ligjor e rregullator, por me zbatimin e tij, pasi mos zbatimi i këtij kuadri është edhe arsyeja e zhvillimit të këtij auditimi, duke marrë parasysh fenomenin e përsëritur të ngritjes së Incineratorëve në vendin tonë, si zgjidhjen parësore në menaxhimin e mbetjeve, duke anashkaluar çdo përcaktim ligjor, apo dhe hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve. Pra problemi social që nxiti këtë auditim lidhet me veprimet kontradiktore sa i takon palëve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve, duke qenë se vendi ynë ka një legjislacion që synon ripërdorimin dhe riciklimin, por në realitet është duke ndërtuar incineratorë për djegien e tyre, duke mos përfshirë kështu në skemën reale as ripërdorimin e as riciklimin. Po kështu, problemi social në fjalë lidhet edhe me faktin e mos marrjes në konsideratë gjatë vendimmarrjes për këtë investim, të faktit se vendi ynë ka ende shumë probleme lidhur me ndarjen në burim të mbetjeve⁴, si dhe mangësitë e mëdha në mbledhjen e të dhënave mbi sasi të mbetjeve të gjeneruara dhe rrjedhimisht të nevojave për trajtimin e tyre. Referuar një studimi të realizuar në vitin 2012⁵, rreth 75% e sasisë së gjeneruar të mbetjeve në Kinë depozitoheshin në landfill. Kjo mënyrë e menaxhimit të mbetjeve për një sasi kaq të konsiderueshme ishte alternativa e vetme pikërisht për arsyen e mos ndarjes në burim të tyre. Sa i takon sasisë së mbetjeve të gjeneruara, rezulton se për vitin 2016⁶ Bashkia Tiranë ka gjeneruar rreth 960 ton mbetje/ditë, në vitin 2017 Bashkia Tiranë ka gjeneruar rreth 850 ton mbetje/ditë⁷ dhe në vitin 2018⁸ janë trajtuar në landfill rreth 886 ton mbetje/ditë. Kjo sasi mbetjesh i referohet sasisë së mbetjeve urbane, mbetjeve inerte dhe të llojeve të tjera. Ndërkohë në kontratën koncesionare për ndërtimin e Incineratorit është dakordësuar depozitimi i një sasive minimale të garantuar vetëm të mbetjeve urbane prej 550 ton në ditë.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Misioni i KLSH në Strategjinë e Zhvillimit 2018 në 2022⁹ kërkon që si *institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që t'i shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit*. KLSH synon të bëhet një institucion model, që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet

³ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3217494/11478276/KS-DK-20-001-EN-N.pdf/06ddaf8d-1745-76b5-838e-013524781340?t=1605526083000#page=111&zoom=100,0,0>

⁴ <https://a2news.com/2020/10/21/incineratore-t-shoqata-e-ricikluesve-problem-ndarja-ne-burim-nderprerja-e-importeve-demton-industrine-e-riciklimit/>

⁵ https://publik.tuwien.ac.at/files/PubDat_210340.pdf

⁶ http://www.akm.gov.al/assets/web_raporti-mjedisit_17.pdf

⁷ http://akm.gov.al/assets/raporti-akm-2017_previeë_09052018.pdf-ardhur-nga-shtepia-botuese.pdf

⁸ <http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>

⁹ Miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 në 2022.

të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.¹⁰


Menaxhimi i integruar i mbetjeve ka qenë gjithmonë në fokus të auditimeve të KLSH, por këtë herë vëmendja është përqendruar tek auditimi mbi investimin e bërë për Incineratorin e Tiranës. Eliminimi i mbetjeve përbën një hallkë jetike në konceptin fillim-përfundim të menaxhimit të mbetjeve dhe rritja e shpejtë e popullsisë, urbanizimi dhe shtimi i aktiviteteve nxisin nevojën e një menaxhimi efikas të mbetjeve. Duke patur parasysh impaktin në kontekstin social-ekonomik dhe shëndetësor të menaxhimit të mbetjeve për qytetarët, por edhe efektet në mjedis, rëndësia e këtij auditimi qëndron në dhënien e një vlerësimi mbi disa elementë të këtij investimi të përzgjedhur. Më konkretisht, rëndësia e këtij auditimi lidhet me vlerësimin e eficiencës së të gjithë procesit përzgjedhës, vendimarrës dhe implementues të kësaj forme menaxhimi të mbetjeve, vlerësimin nëse kjo hallkë e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve ishte e nevojshme dhe e duhura për vendin tonë, si dhe aspekte të kapaciteteve logjistike e financiare për tu përballuar nga njësitë e qeverisjes vendore të përfshira në këtë projekt.

2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të politikave, ndërtimit dhe funksionimit të Incineratorit të Tiranës, gjatë kësaj faze të auditimit, grupi ka vendosur të përfshijë si subjekte Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si ish-Autoritet Kontraktor që ka zhvilluar procedurën e prokurimit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si AK aktual dhe Bashkinë e Tiranës, si palë në vlerësimet paraprake dhe përdoruese e kësaj vepre.

Figura 1 – Harta e përgjegjësiave të strukturave të përfshira



Përpunoi: Grupi i auditimit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në funksion të objektit të auditimit, është institucioni përgjegjës që ushtronte kompetencat në fushën e mbetjeve urbane dhe interurbane dhe përpunimit të tyre¹¹. Me ndryshimet e vitit 2017, kjo ministri ka në kompetencë trajtimin e mbetjeve vetëm në kuadër politikash. MTM është ish-Autoriteti Kontraktues, firmëtar i Kontratës së Koncesionit për ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e Energjisë Elektrike (30.08.2017) me kompaninë fituese OI E. B.V. shpk. Pranë kësaj ministrie është hartuar plani i fizibilitetit të projektit dhe është zhvilluar procedura e prokurimit për këtë

¹⁰ Vizioni i KLSH, nga Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018 në 2022, faqe 19.

¹¹ Përcaktuar në kreun I të Kontratës Koncesionare nr. Prot 6597, datë 30.08.2017

kontratë. Strukturat aktuale në MTM, të lidhura me objektin e auditimit janë paraqitur në organigramën e pjesshme:

Figura 2 – Organigrama e pjesshme MTM




Burimi: MTM

Përpunoi: Grupi i auditimit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me ristrukturimin e saj në vitin 2017¹², ushtron veprimtarinë në disa sektorë përfshirë edhe fushën e mbetjeve urbane në funksion të planifikimit territorial dhe infrastrukturës së mbetjeve. Në këtë kuadër, me marrjen e kompetencave të reja nga ana e këtij institucioni, disa nga kontratat koncesionare të fushës përfshirë edhe ajo e Incineratorit të Tiranës, u transferuan pranë MIE. Aktualisht, MIE ushtron rolin dhe mban përsipër përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktor në këtë kontratë. Strukturat e MIE, të lidhura me objektin e auditimit janë paraqitur në organigramën e pjesshme:

Figura 3 – Organigrama e pjesshme MIE




Burimi: MTM

Përpunoi: Grupi i auditimit

Bashkia Tiranë është bashkia më e madhe e qarkut me të njëjtin emër. Kjo bashki, si përfituese e këtij projekti, depoziton mbeturinat në landfillin e Sharrës dhe paguan tarifën mujore të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu, ky institucion bën monitorimin dhe rakordimin e sasisë së depozituar të mbetjeve urbane. Strukturat e Bashkisë Tiranë, të lidhura me objektin e auditimit janë paraqitur në organigramën e pjesshme:

Figura 4 – Organigrama e pjesshme e Bashkisë Tiranë



Burimi: Bashkia Tiranë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Njësia e Zbatimit të Projektit është një strukturë *ad-hoc* e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor për të monitoruar realizimin e kontratës dhe është krijuar disa muaj pas datës efektive të saj. Sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, ajo duhet të ketë në përbërje të saj dy përfaqësues nga MTM, një nga MIE dhe dy nga Bashkia Tiranë. Struktura raporton periodikisht në MIE (si Autoritet

¹² VKM nr. 504, datë 13.09.2017 òPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Kontraktor), në lidhje me detajet e zbatimit të kontratës. Aktualisht, në fazën studimore të këtij auditimi, struktura e NJZP nuk është e plotë, pas dorëheqjes së përfaqësuesit të MTM.

2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjen nën auditim

Për sa i përket objektit të këtij auditimi, në kushtet kur institucionet e përfshira kanë përgjegjësi dhe fusha veprimi të ndryshme, nevojitet një strategji ndërsektoriale për të koordinuar punën. Gjatë kohës që është negociuar kjo vepër dhe është nënshkruar kontrata, sektori i mbetjeve rregullohej nga Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve¹³ (2011). Duke qenë se ky dokument është hartuar më herhëm në kohë, shprehet pak në lidhje me incineratorët. Megjithatë, ai përcakton se ministria përgjegjëse për mjedisin është ajo që duhet të hartojë rregullat dhe ligjet për të gjitha fazat e menaxhimit të mbetjeve (ndarja, ripërdorimi, riciklimi, kompostimi, hedhja, djegia)¹⁴.

Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 óPër menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar është akti që rregullon nga ana teknike sektorin e mbetjeve dhe çështjen objekt auditimi. Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi. Më konkretisht, rregullat për incinerimin e mbetjeve trajtohen në nenin 47 të tij.

Procedurat për dhënien e kontratave koncesionare rregullohen nga Ligji nr. 125/2013 óPër Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndryshuar. Gjithashtu, ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, si edhe politikën e këtyre koncesioneve e autoritetin për zbatimin e tyre¹⁵. Rregullat e detajuara për procedurat e dhënies me koncesion parashikohen me VKM nr. 575, datë 10.07.2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat, i ndryshuar.

Krahas akteve të mësipërme, grupi përdor kritere të përcaktuara edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore, të cilat janë të lidhura me objektin e auditimit. Për më tepër, mund të përdoren edhe praktika të mira nga vendet e rajonit (të renditura tek kriteret audituese) për të krahasuar çështje specifike të tij.

2.2.1 Kriteret audituese

2.2.1.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, miratuar me VKM nr. 175, datë 19.01.2011;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI).

2.2.1.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raportet vjetore mbi gjendjen e mjedisit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (2016-2019);
- Raport vjetor i përmbledhur i MFE óPerformanca e kontratave të koncesioneve/partneritetit publik privat, 2019;
- Raporti Përfundimtar, Dhjetor 2012 Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës;
- Raporte të tjera monitorimi, studime dhe analiza të subjekteve nën auditim.

2.2.1.3 Kriteret teknike

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.125/2013 óPër koncesionet dhe partneritetin publik privat, i ndryshuar;
- Ligj nr. 10463, datë 22.9.2011, óPër menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar;
- VKM nr. 319, datë 31.5.2018 óPër miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve;

¹³ VKM nr. 175, datë 19.01.2011 óPër miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Neni 2 i Ligjit 125/2013, i ndryshuar

- VKM nr. 575, datë 10.7.2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privató;
- VKM nr. 313, datë 27.4.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privató;
- VKM nr. 504, datë 13.9.2017 óPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisëó;
- VKM nr. 509, datë 13.9.2017 óPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisitó;
- Urdhër i MM nr. 105, datë 19.05.2016 óPër miratimin e rregullores së brëndshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Mjedisitó;
- Urdhër i KM nr. 119, datë 22.07.2016 óPër disa ndryshime dhe shtesa në Urdhërin nr.33, datë 12.03.2015 të Kryeministrit óPër miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisitó, i ndryshuaró;
- Urdhër nr. 223, datë 23.11.2017, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, óPër marrjen në dorëzim të dokumentacionit në lidhje me procedurat për óNdërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisëó, óDhënies me koncesion e Ndërtimit e Administrimit të Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhim Energjieó, si dhe ódhënien me koncesion për Ndërtimin e Landfillit, Incineratorit dhe Rehabilitimi i Venddepozitimeve Ekzistuese, Tiranëó;
- Urdhër nr. 24, datë 14.11.2017, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, óPër dorëzimin e dokumentacionit në lidhje me procedurat për óNdërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisëó, óDhënies me koncesion e Ndërtimit e Administrimit të Impiantit të Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier dhe Prodhim Energjieó, si dhe ódhënien me koncesion për Ndërtimin e Landfillit, Incineratorit dhe Rehabilitimi i Venddepozitimeve Ekzistuese, Tiranëó;
- VKB nr. 59, datë 30.12.2015 óPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranësó;
- VKB nr. 48492, datë 20.12.2019 óPër miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së apartit të Bashkisë Tiranëó.

2.2.1.4 Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Studim Doktorature óMenaxhimi i mbetjeve urbane dhe përfitimet ekonomike prej tyreó, 2016 A.Guri, Tiranë;
- The Belgrade Solid Waste Public Private Partnership: Corporate interests vs. the circular economy, December 2019, Ksenija Radovanoviç, Zero Waste Europe;
- Landfill emission reductions only tell half the story as GHG emissions from Ëaste-to-Energy incineration double, November 2020, Janek Vahk, Zero Waste Europe;
- A Cost-Benefit Analysis of Waste Incineration with Advanced Bottom Ash Separation Technology for a Chinese Municipality ñ Guanghan, Jiao Tang, Msc Programme Environmental Technology & International Affairs, Diplomatiche akademie Wien, Vienna 2012;
- A Study on the Economic Valuation of Environmental Externalities from Landfill Disposal and Incineration of Waste, European Commission, DG Environment, Oct 2000.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni që harton Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit. MTM ka përgjegjësi për të zbatuar programin e qeverisë për trajtimin e mbetjeve, si dhe ka detyra të tjera që i ngarkohen nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e MTM-së në procesin e menaxhimit të mbetjeve janë:

- harton Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- harton programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- përgatit dhe publikon çdo 3 vjet një raport për statistikën e mbetjeve në Shqipëri;
- përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në mënyrë periodike për secilin nga përbërësit e mjedisit.

Krahas përgjegjësiave për hartimin e akteve rregullatore në fushën e mbetjeve, MTM ka qenë edhe Autoriteti Kontraktor i koncesionit objekt auditimi deri në momentin që kjo përgjegjësi është transferuar tek MIE.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë monitoron ecurinë e zbatimit të kontratës, në rolin e Autoritetit Kontraktor. Ky monitorim bëhet nëpërmjet Njesisë së Zbatimit të Projektit (NJZP), e cila grumbullon informacion nga raportimet e koncesionarit dhe vizitat në terren. Kjo strukturë harton:

- raporte periodike 3-mujore, të cilat ia paraqet Autoritetit Kontraktor.

Bashkia Tiranë është përfituesja kryesore e këtij projekti. Ky institucion, ndër të tjera, bën:

- monitorimin dhe rakordimin e sasisë së depozituar të mbetjeve që dërgon në venddepozitim.
- pagesat e faturave mujore, përkundrejt çmimit për ton të përcaktuar në kontratë;
- raportime pranë MFE në lidhje me sasinë dhe pagesat e kryera për depozitimin e mbetjeve.

2.4 Pesha në buxhet dhe PBB

Në funksion të identifikimit të vlerësimit financiar për problemin social në fokus, si dhe për të qartësuar të dhënat për taksapaguesit dhe opinionin publik, grupi i auditimit ka identifikuar gjatë fazës studimore shumat monetare të kontratave koncesionare sipas sektorëve ku ato janë shpërndarë, të detajuar në formë tabelare dhe grafike sipas dinamikës kohore të periudhës audituese dhe më tej.


Tabela 1 - Vlera e investimit koncesionar sipas sektorëve (në mijë lekë)

Viti	Bujqësi	Energji	Kontroll Fiskal	Mjedis	Shëndetësi	Transport	Zhvillim Ekonomik	Total
2004						9,784,254		9,784,254
2007		932,970						932,970
2008		169,962,625						169,962,625
2009	1,906,500	59,206,705				561,003	1,435,691	63,109,900
2010		1,545,604						1,545,604
2011		41,893,436				3,191,825		45,085,261
2012		10,327,770				-		10,327,770
2013		71,220,629	3,281,499			7,100,758		81,602,887
2014		9,754,772		3,581,476				13,336,249
2015		1,860,931			1,805,302	2,636,958		6,303,192
2016		15,024,435		3,727,189	1,178,355	10,448,723		30,378,703
2017		7,636,381		17,121,152		238,374		24,995,907
2018		29,080,985		17,139,106		24,000,000		70,220,092
TOTAL	1,906,500	418,447,250	3,281,499	41,568,924	2,983,657	57,961,897	1,435,691	527,585,420

Burimi: ATRAKO, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Prej vitit 2004 dhe deri më 2018 vlera totale e investimit të kontratave koncesionare për të gjithë sektorët së bashku është **527,585,420,885 lekë**, nga ku sektori i mjedisit përbën 7.88% të tyre në raport me sektorët e tjerë, ilustruar më poshtë:

Figura 5 - Shpërndarja e Koncesioneve sipas sektorëve (në %)



Burimi: ATRAKO, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Për periudhën objekt auditimi koncesionet e dhëna në sektorin e mjedisit, llogariten të jenë në vlerën e 41,568,924,844 lekë, nga ku investimi në Incineratorin e Tiranës me vlerë **17,139,106,821 lekë** përbën **41.23%** të kontratave koncesionare të dhëna për sektorin e mjedisit për periudhën 2014-2018 dhe 24.4% të vlerës totale të investimeve koncesionare gjatë vitit 2018. Nëse do të krahasonim këto të dhëna me treguesin fiskal të PBB-së të secilit vit të periudhës objekt auditimi, pasqyrohet një trend relativ rritës të koncesioneve në sektorin e mjedisit, ku konkretisht; për vitin 2016 në raport me PBB-në zënë 0.3%, për vitin 2017 zënë 1.1%, për vitin 2018 zënë 1.04 % të PBB-së.

Tabela 2 - Vlera e investimeve koncesionare në Mjedis në raport me PBB-në (në lekë)

Viti	Mjedis	PBB
2016	3,727,189,322	1,475,300,000,000
2017	17,121,152,055	1,552,900,000,000
2018	17,139,106,821	1,647,600,000,000

Burimi: MFE16, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Në funksion të identifikimit të shumave monetare si pjesë e të ardhurave buxhetore që iu akordohen subjekteve përgjegjëse për problemin social në vëmendje, grupi i auditimit ka përpunuar këto të dhëna për Bashkinë Tiranë, funksioni i së cilës për sektorin e mbetjeve ekzekutohen nga vlerësimet financiare ilustruar si në tabelën më poshtë:

Tabela 3 - Buxheti plan dhe fakt i Bashkisë Tiranë për menaxhimin e mbetjeve (në lekë)

Viti	Burimi i financimit	Plan	Fakt	Realizimi
2016	Te ardhura BT + Transferta e Pakushtezuar	15,872,544,653	9,735,307,588	61%
2017	Te ardhura BT + Transferta e Pakushtezuar + Transferta Sektoriale	15,879,660,356	10,612,201,748	67%

¹⁶ VKM nr. 4, datë 9.1.2019 óPër miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2020 ñ 2022ó

2018	Te ardhura BT + Transferta e Pakushtezuar + Transferta Sektoriale	20,286,682,977	15,010,426,149	74%
2019	Te ardhura BT + Transferta e Pakushtezuar + Transferta Sektoriale	22,611,990,518	18,332,780,716	81%
2020	Te ardhura BT + Transferta e Pakushtezuar + Transferta Sektoriale	23,689,493,484	13,565,521,391	57%

Burimi: Bashkia Tiranë, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Buxheti i Bashkisë Tiranë për menaxhimin e mbetjeve të qytetit, për periudhën objekt auditimi 2016-2020, organizohet si përmbledhje e tre programeve buxhetore, konkretisht prej vlerësimit financiar të: Programit të shërbimeve publike vendore, Programit të pastrimit të Qytetit dhe Programit të Shpenzimeve për landfillin e Sharrës. Në mënyrë eksplicite grupi i auditimit ka gjeneruar të dhënat mbi shpenzimet e Bashkisë Tiranë për landfillin e Sharrës, objekt i projektit të investimit i cili është në fokus të këtij auditimi. Si i tillë vlerësimi financiar për këto vite si dhe ndarja e peshës së shpenzimeve që mbulohen nga të ardhurat e bashkisë, transferata e kushtëzuar dhe ajo e pakushtëzuar, paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela 4 - Buxheti plan dhe fakt projektit të incinerimit dhe rehabilitim i landfillit të Sharrës (në lekë)

Viti	Burimi financimit		Plan	Fakt
2017	Te Ardhurat e B.T	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	15,000,000	-
2018	Te Ardhurat e B.T	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	224,000,000	224,000,000
2019	Te Ardhurat e B.T	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	477,124,798	477,124,798
2019	Transferta Kushtezuar	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	500,000,000	500,000,000
2020	Te Ardhurat e B.T	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	480,000,000	480,000,000
2020	Transferta Kushtezuar	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	500,000,000	500,000,000
2020	Transferta e pakushtezuar	Shpenzime për landfillin e Sharrës për projektin e incineritorit në Tiranë	100,000,000	100,000,000

Burimi: Bashkia Tiranë, përpunoi grupi i auditimit KLSH

Këto shpenzime paraqiten në trend të ndjeshëm ritës, ku vetëm për vitet 2017 dhe 2018 shpenzimet janë përballuar vetëm nga të ardhurat e veta të bashkisë dhe për vitet 2019 dhe 2020, ky program buxhetor është mbështetur nga transferatat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Konkretisht, nga një vlerësim financiar prej 15,000,000 lekë për vitin 2015 deri në 1,080,000,000 lekë për vitin 2020, ku peshën kryesore e zë Transferta e Kushtëzuar për realizimin e shpenzimeve që lidhen me tarifën koncesionare për sasi mbetjesh të depozituara në landfill, referuar kjo detyrimeve kontraktuale.

2.5 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore

Gjatë fazës studimore, MTM dhe Bashkia Tiranë i janë përgjigjur në kohë kërkesës së grupit të auditimit për takimin prezantues dhe konsultues. Më tej, grupi ka zhvilluar takimin prezantues me këto dy institucione. MIE ka kërkuar shtyrjen e auditimit për një kohë të dytë për shkak të mbingarkesës dhe auditimeve të tjera paralele. Takimi prezantues me këtë institucion është zhvilluar në muajin Shkurt.

Sa i takon fazës studimore, MIE dhe Bashkia Tiranë kanë qenë korekt në zbatim të afateve për të vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, të shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse. Grupi i auditimit ka hasur në prolemtika me MTM, duke qenë se dokumentacioni i administruar prej tyre lidhur me çështjen objekt auditimi, nuk është i plotë. Njëkohësisht MTM ka tejkaluar

afatet për vendosjen në dispozicion të procedurës elektronike të konkurrimit në SPE për këtë projekt, ku vihet re se korespondencat shkresore për këtë çështje kanë vijuar prej 4 javësh. Grupi i auditimit ka zhvilluar takime me anëtarë të ndryshëm të stafit dhe intervista paraprake me personat përgjegjës në MTM, MIE dhe Bashkinë Tiranë. Një problem i hasur kanë qenë ndryshimet e shumta në stafin përgjegjës në MTM, i cili ka qenë pjesë e procedurave të studimit dhe prokurimit të kontratës koncesionare, ku thuajse të gjithë personat e përfshirë nuk janë më pjesë e ministrisë.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Në këtë auditim, me qëllim kategorizimin e risqeve të aktivitetit të subjekteve, grupi ka përdorur analizën PESTLE.

Figura 6 – Analiza PESTLE

Politike	Ekonomike	Sociale	Teknologjike	Ligjore	Mjedisore
• Mos planifikimi i metodës së incinerimit në dokumentet strategjike për investimet; • Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve e cilëson metodën e incinerimit si më pak të preferuar; • Mungesa e studimeve që mbështesin metodën e incinerimit të mbetjeve dhe ngritja e studimeve që hedhin poshtë këtë metodë; • Ndryshimet në organizim dhe strukturë të autoritetit kontraktor	• Mungesa e studimeve për shkallën e përballimit të tarifës në rastin e metodës së incinerimit; • Paqartësi lidhur me kostot e shpronësimit për zonën ku do të operojë impianti; • Kosto të shtuara për buxhetet e bashkive në rast të mos përmbushjes së volumit të kërkuara të mbetjeve.	• Rritja e papunësisë ndër punonjësit e landfillit si pasojë e automatizimit të procesit të asgjësimit;	• Mos ndarja në burim e mbetjeve sjell mos funksionimin eficient të impiantit; • Risku i mos garantimit të sasisë së nevojshme për venien në punë të impiantit sjell mos funksionimin eficient të tij.	• Problematika lidhur me identifikimin e statusit të tokës ku do të operojë impianti;	• Dëmet e konsiderueshme në mjedis dhe shëndet si pasojë e shkarkimeve të CO₂ • Cënon përpjekiet për riciklim dhe reduktim të mbetjeve.

Përpunoi: Grupi i auditimit


3.2 Objektivat e auditimit

Duke qenë se grupi i auditimit vlerësoi një projekt konkret dhe jo aktivitetin e një institucioni publik në veçanti, objektivi kryesor i këtij auditimit ishte kombinimi i analizes së 3(tre)-E-ve të auditimit të performancës. Në këtë kontekst, grupi i auditimit u fokusua në aspektin financiar sa i takon analizës kosto-përfitim të këtij investimi, shoqëruar me analizën e tarifave të vendosuar për NJQV-të e qarkut Tiranë, si dhe në aspektin e eficiencës dhe efektivitetit sa i takon, procesit të vendimmarrjes për këtë projekt dhe transparencës në procedurën konkurruese.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, auditimi ofroi një tablo të qartë mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve në qarkun Tiranë dhe përputhshmërinë e kësaj metode të zgjedhur me politikat strategjike vendase dhe direktivat ndërkombëtare të fushës.

3.3 Pyetjet e auditimit

Piramida e pyetjeve të auditimit:



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim përfshiu të gjitha aktivitetet, programet dhe dokumentacionin e subjekteve në lidhje me studimin paraprak të veprës, procedurat e prokurimit dhe ecurinë e zbatimit të kontratës për incineratorin e Tiranës. Subjektet e audituara janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë. Performanca e tyre në drejtim të detyrave të tjera institucionale nuk do të mbulohet nga ky auditim.

Periudha nën auditim përfshin vitet 2017 në 2020, të cilat përkon me kohën e studimit të koncesionit dhe lidhjes së kontratës e në vazhdim. Pasi u miratua programi i auditimit, faza e terrenit zgjati nga 10.05.2021 deri në 10.06.2021. Aktivitetet e kësaj faze u zhvilluan në ambientet e subjekteve të audituara nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe intervistave me personat përgjegjës. Gjithashtu, grupi zhvilloi vizita në terren në zonën ku ndërtohet vepra për të parë ecurinë e zbatimit të kontratës.

4. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, grupi i auditimi u përpoq të jepte përgjigje pyetjes kryesore: **“A ka qenë efektive dhe eficiente MTM në përzgjedhjen e metodës së duhur për menaxhimin e mbetjeve për qarkun e Tiranës?”**. Në përfundim të auditimit, grupi arriti në mesazhin si më poshtë:

Drejtimit dhe politikat e Ministrisë së Mjedisit (sot MTM) në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane. Procedura e planifikimit të projektit të Incineratorit të Tiranës ka mungesa dhe paqartësi në lidhje me propozimin paraprak të ardhur në ministri nga shoqëria dhe konfirmimin e miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Financave (sot MFE).

Mungesa e vendimmarrjes së MFE në cilësinë e vlerësuesit dhe miratuesit paraprakisht të gjithë

projektit koncesionar dhe PPP, nga pikëpamja e implikimeve financiare për incineratorin e Tiranës, shpreh në mënyrë të qartë paqëndrueshmërinë dhe ndërmarrjen e angazhimeve publike që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përbalueshmërinë dhe efektivitetin e projektit. Mungesa e përgjigjeve zyrtare dhe dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e së cilave lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar, ka devijuar procesin e rregullt të këtij angazhimi duke sjellë mungesë eficiense dhe identifikim të risqeve potenciale, konkretisht ai fiskal dhe financiar lidhur me kostot e shpronësimeve dhe përbalimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike. Mungesa e dakordësisë me shkrim e bashkive të tjera të Qarkut Tiranë përveç Bashkisë Tiranë, provokon në të ardhmen kosto financiare për këto bashki, mos përfshirja e të cilave mbi këtë argument do të sjellë mungesë efektiviteti për realizimin e projektit të Incineratorit të Tiranës. Mos dakortësimi i tarifës prej 29 euro/ton së depozitimit në landfill, ka dyfishuar shpenzimet për Bashkinë Tiranë, të paguara nga MIE si transferues i óTransfertës së Pakushtëzuarô, për zërin e pastrimit të qytetit. Aktualisht çmimi i paguar 29 euro/ton nuk është çmimi real i shërbimit që kryhet, pasi kjo tarifë përfshin edhe incinerimin e mbetjeve proces i cili nuk është kryer deri më sot. Procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncension nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimet ligjore. Janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit, si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK ashtu edhe nga Koncensionari.

4.1 A ka qenë efektive procedura e vendimmarrjes?

4.1.1 A ka qenë i mbështetur në kuadrin rregullator dhe strategjik planifikimi i këtij investimi?

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka pasur progres në lidhje me zhvillimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, zbatimi në nivel rajonal dhe arritja e objektivave të dakordësuar ka mbetur ende prapa në garantimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë. Qarku Tiranë është ai që gjeneron rreth 30% të mbetjeve në rang vendi dhe ka rreth 1/3 e popullsisë sipas të dhënave të Census 2011 të INSTAT. Konkretisht, përgjatë viteve, Tirana ka depozituar mbetjet në landfillin e Sharrës, i cili ndodhet rreth 6 km në jugperëndim të kryeqytetit. Në vitin 2008 u bë mbyllja e landfillit të vjetër duke u zgjeruar në një landfill të ri. Megjithatë, që në vitin 2013, volumet e mbetjeve kishin kaluar kapacitetin për të cilin ishin projektuar. Në shumë raste, mbetjet industriale dhe mbetjet urbane depozitoheshin në të njëjtin vend duke sjellë efekte negative në mjedis, etj.

Figura 7 – Landfilli i Sharrës përpara rehabilitimit



Burimi: iebv.al

Që nga viti 2017, landfilli i Sharrës menaxhohet nga një shoqëri private, përfutuese e koncesionit me propozim të pakërkuar për ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese. Deri më tani, në kuadër të këtij investimi është realizuar rehabilitimi i impiantit ekzistues, ndërsa sipas grafikut të punimeve ndërtimi i impiantit të incenerimit të mbetjeve është ende në proces. Ky është incineratori i tretë i ndërtuar në vendin tonë, krahas atij të Elbasanit dhe të Fierit.

Aktualisht sektori i mbetjeve rregullohet nga Strategjia Sektoriale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta 2020¹⁷. Ndërsa gjatë periudhës objekt auditimi, dokumenti strategjik në fuqi për sa i përket kësaj fushe është Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve, miratuar në vitin 2011¹⁸. Ky dokument mbështetet në parimet e përcaktuara nga legjislacioni i BE-së në atë periudhë, konkretisht Direktivën kuadër 2008/98/KE. Kjo e fundit, adaptuar në nëntor 2008, parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve, duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Direktiva krijon një hierarki të mbetjeve, me qëllim parandalimin e tyre duke paraqitur programe, si një instrument politik për shtetet anëtare. Riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve promovohen me objektiva, si kriteret e mbledhjes së veçuar dhe efikasiteti i energjisë. Gjithmonë me reduktimin e prodhimit të mbetjeve në fokus, Direktiva propozon hierarkinë si më poshtë¹⁹:

- 1- **Parandalimi** - masat që merren para se një substancë, material apo produkt të kthehet në mbetje, që të pakësohet: (a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve apo zgjatjen e jetës së tyre; (b) ndikimi i padëshirueshëm në mjedis apo në shëndetin e njeriut i mbetjeve të gjeneruara; apo (c) përmbajtja e substancave të dëmshme në material dhe produkte;
- 2- **Përgatitja për ripërdorim** - operacione rikuperimi të kontrollit, pastrimit ose riparimit, me anë të cilave produktet ose përbërësit, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t'u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak; ripërdorimi është çdo operacion, me anë të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar;
- 3- **Riciklimi** - është çdo operacion rikuperimi me anë të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, që përdoren si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin e mbetjeve për t'u shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo për mbushje;
- 4- **Rikuperimi** - është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materialet e tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar ose që mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në impiant apo në përgjithësi në ekonomi;
- 5- **Asgjësimi** - është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë dytësore rikuperimin e substancave ose të energjisë.

Lista e mësipërme është një hierarki, ku renditen metodat e reduktimit të mbetjeve nga më e preferueshmja (1) tek ajo më pak e preferueshme (5). Në këtë kuadër mund të përmendim edhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, e cila nuk është një alternativë në kuptimin e hierarkisë, por më tepër një parakusht për arritjen e objektivave specifike brenda sektorit të menaxhimit të mbetjeve. Për shembull, ai është një parakusht i rëndësishëm për realizimin e riciklimit të mbetjeve.

¹⁷ VKM nr. 418, datë 27.05.2020 për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035

¹⁸ VKM nr. 175, datë 19.01.2011 për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve

¹⁹ Neni 3 i Direktivës Kuadër 2008/98/KE

Në përputhje me nenin 11 të Direktivës 2008/98/KE, VKM nr. 418, datë 25.06.2014 óPër grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burimó parashikonte që brenda vitit 2018, të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të bënin grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme²⁰. Në këtë drejtim, Shqipëria nuk ka bërë hapa përpara, ku vetëm Bashkia Tiranë ndërmori një iniciativë të tillë disa vite me parë, e cila hasi vështirësi për t'u zbatuar.

Pikërisht për promovimin e metodave më të preferuara të hierarkisë së mbetjeve është zhvilluar projekti óMbështetje për minimizimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve (reduktim, ripërdorim dhe riciklim) në Republikën e Shqipërisëó, me mbështetjen e Agjencisë për Bashkëpunim Kombëtar të Japonisë (JICA). Promovimi i 3R-ve është në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe europian për reduktimin e sasisë së mbetjeve. Aktivitetet e parashikuara në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar gjatë vitit 2017, duke përfshirë edhe bashkitë e ndryshme të vendit si palë interesi.

Nga ana tjetër, hierarkia e menaxhimit të mbetjeve e thekson në mënyrë të qartë faktin që asgjësimi është mënyra e fundit për t'u përdorur, dhe mund të përdoret vetëm në rastet kur mënyrat e tjera të hierarkisë nuk mund të jenë të zbatueshme²¹. Për më tepër, asgjësimi është faza më pak e dëshirueshme e hierarkisë për arsye se nëpërmjet asgjësimit humbasin vlerat e materialeve. Ndonëse vendi ynë ende nuk ka arritur progres të theksuar në lidhje me objektivat për riciklimin (apo R-të e tjera), fokusi i Ministrisë së Mjedisit është zhvendosur drejt incineratorëve. Incineratori, si impiant i djegies së mbetjeve për prodhimin e energjisë, bën pjesë në hallkat e fundit të hierarkisë dhe duhet të përdoret pasi të jetë konsideruar mundësia e parandalimit apo riciklimit të mbetjeve. Në literaturën e fushës, incinerimi konsiderohet si forma më pak e preferueshme e rikuperimit ose si forma më e mirë e asgjësimit të mbetjeve²². Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa nga avantazhet dhe disavantazhet e incinerimit:

Tabela 5 - Avantazhet dhe Disavantazhet e Incinerimit

Avantazhe	Disavantazhe
1. Redukton sasinë e mbetjeve; 2. Prodhon energji; 3. Lehtëson ngarkesën në landfille;	1. Kosto shumë të larta; 2. Dekurajon riciklimin; 3. Mund të çlirojë substanca të rrezikshme nëse nuk instalohen filtrimet e duhura;

Burimi: <https://www.conserve-energy-future.com/advantages-and-disadvantages-incineration.php>

Kostot kapitale për incineratorët e rinj, si dhe funksionimi, mirëmbajtja dhe operimi në mënyrën e duhur të këtyre pajisjeve, nuk janë investim i vogël për qeveritë. Ata kushtojnë shumë për tu ndërtuar dhe për tu operuar, krahasuar me format e tjera të menaxhimit të mbetjeve. Për shembull, në një nga aktet e shtetit të Rhode Island në SHBA theksohet se *óDjergia e mbetjeve të ngurta është metoda më e kushtueshme e asgjësimit të mbetjeve me kosto përshkallëzuese të njohura dhe të panjohura, të cilat do të vendosnin ngarkesa substanciale dhe të paarsyeshme si në buxhetin e shtetit ashtu edhe në atë lokal, madje deri në rrezikimin e interesit publikó*²³. Ndryshe nga Rhode Island, në vitin 2011, Bashkia e Harrisburg mori përsipër të financojë një projekt për ndërtim incineratori duke marrë një kredi prej qindra miliona dollarësh, e cila në fund e çoi qeverisjen lokale në falimentim.

Kostot e një impianti të tillë janë në drejtim të energjisë së shpenzuar për operimin e tij, aq sa ndonjëherë mund të eklipsojnë edhe benefitet e energjisë së përfituar. Një artikull shkencor sugjeron se tre deri në pesë herë më shumë energji mund të kursehet përmes strategjive alternative të tilla si parandalimi, ripërdorimi, riciklimi dhe kompostimi sesa mund të gjenerohet nga djergia²⁴. Për shembull, një incinerator mund të djegë një ton letër dhe të gjenerojë rreth 8,200 megaxhaul

²⁰ Pika IV e VKM nr. 418, datë 25.06.2014

²¹ Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve 2011

²² óMunicipal Solid Waste Incineration: Recovery or Disposal. Case Study of City Timisoara, Romaniaó; Daniel Vaida, Dorin Lelea

²³ State Senate Act 92-S 2502 (Rhode Island)

²⁴ óRecycling versus incineration: an energy conservation analysisó; Jeffrey Morris

energji. Riciklimi i të njëjtit ton letër kursen rreth 35,200 megaxhaul të energjisë duke përfshirë në mënyrë efektive energjinë e nevojshme për prodhimin dhe furnizimin me letër të re, karburantin dhe kostot e energjisë që lidhen me prerjen e drurit, furnizimin me energji dhe transportimin e letres në treg. Gjithashtu, ky studim tregon se për 24 nga 25 materiale të mbetjeve të ngurta, riciklimi kursen më shumë energji sesa gjenerohet nga djegia e tyre²⁵.

Siç u përmend edhe më lart, incineratori i Tiranës është i treti në vendin tonë, pas atij të Elbasanit dhe Fierit. Kjo zhvendosje e fokusit drejt impianteve të incenerimit nuk shkon në të njëjtin drejtim me frymën e Strategjisë së Menaxhimit të Mbetjeve, standardeve dhe legjislacionit, të cilat promovojnë fokusimin drejt parandalimit dhe riciklimit. Incinerimi jo vetëm që dekurajon përdorimin e këtyre metodave, por madje kërkon një sasi të caktuar mbetjesh për të operuar në mënyrë eficiente. Për shembull, në kontratën koncesionare parashikohen kuota ódyschemeó të mbetjeve që NJQV-të e qarkut Tiranë duhet të sjellin në impiant, të cilat nëse nuk arrihen, kostoja financiare e të cilave do të mbulohet nga sektori publik. Në studimin e fizibilitetit të hartuar nga Komisioni i ngritur nga Autoriteti Kontraktor (Ministria e Mjedisit në sot MTM) theksohet shprehimisht se *ó...shpresat janë për një rritje të sasisë së mbetjeve si rezultat i rritjes së konsumit dhe popullsisëó*²⁶. Po ashtu, në planin e biznesit të paraqitur nga shoqëria fituese parashikohet një rritje e sasisë së mbetjeve, rrjedhimisht edhe të ardhurave, përgjatë viteve të operimit²⁷. Ndërkohë, praktikat më të mira që ka adoptuar Organizata Botërore e Shëndetësisë inkurajojnë përdorimin e incineratorëve vetëm për llojet më të rrezikshme të mbetjeve²⁸.

Megjithatë duhet theksuar se projekti koncesionar parashikon edhe impiante të tjera krahas atij të incinerimit, ndër të cilët është një zonë riciklimi dhe diferencimi. Ky i fundit do të operojë në mënyrë mekanike dhe manuale (forcë punëtore) dhe do të kryejë një përzgjedhje të mbeturinave që shkojnë për djegie.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, nuk rezulton që Ministria të ketë zhvilluar analiza të detajuara, të ketë negociuar me publikun/palë interesi apo të ketë marrë në konsideratë përdorimin e metodave të tjera (më të favorizuara nga hierarkia). Duke qenë se kontrata koncesionare për ndërtimin e këtij objekti është nënshkruar nga Ministria e Mjedisit (si Autoritet Kontraktues), ndërsa paralelisht ushtrohej edhe projekti për minimizimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve, mund të konkludohet se drejtimet dhe politikat e këtij institucioni në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane.

Realizimi i këtij koncesioni është bërë me propozim të pakërkuar, parashikuar nga dispozitat e Ligjit nr. 125/2013 *óPër Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*", i ndryshuar²⁹ dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 *óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privató*³⁰. Sipas akteve në fjalë, çdo operator ekonomik ose grup operatorësh, mund të paraqesë një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP. Propozimi i dorëzohet autoritetit kontraktues, të cilit ligji i jep autoritetin të ndërmarrë procedurën e dhënies së kontratës të koncesionit/PPP-së. Në rastin e projektit në fjalë, autoriteti kontraktues ka qenë Ministria e Mjedisit (sot Ministria e Turizmit dhe Mjedisit). Propozimi i pakërkuar duhet të përmbajë³¹:

- 1- përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore, kontekstin e zhvillimit dhe, nëse është e përshtatshme, një panoramë të tregut;
- 2- parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave dhe përshkrim të përgjithshëm të projektit;

²⁵ Ibid.

²⁶ Kapitulli 6 i Studimit të Fizibilitetit në Analiza Ekonomike dhe Financiare

²⁷ Kapitulli 6 i Planit të Biznesit në Parashikimi i të ardhurave

²⁸ Shih: https://www.who.int/water_sanitation_health/medicalwaste/en/smincinerators3.pdf

²⁹ Neni 25 në Propozimet e pakërkura

³⁰ Nenet 10-15

³¹ Neni 11 i VKM nr. 575, datë 10.07.2013

- 3- përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;
- 4- bashkërendimin me politikat e investimeve të përgjithshme, sektoriale apo rajonale;
- 5- analizat teknike; ndikimet mjedisore dhe sociale; si dhe analizat ekonomike dhe financiare.

Në vazhdim hartohet një raport përmbledhës që vlerëson aspektet e ndryshme të propozimit dhe mbi bazën e tij, Autoriteti Kontraktues vendos nëse do ta pranojë apo jo propozimin dhe të procedojë më tej me hartimin e studimit të fizibilitetit. Në dokumentet e vendosura në dispozicion nga MTM nuk konstatohet prania e propozimit të pakërkuar të paraqitur nga operatori dhe raportit përmbledhës në lidhje me të.

Përpara marrjes së vendimit për investime, komisioni i koncesionit/PPP harton një studim fizibiliteti. Pavarësisht se sa i detajuar është propozimi, autoriteti kontraktues verifikon me kujdes të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për kontekstin e analizës³². Në këtë kuadër, me anë të Urdhrit nr. 169, datë 05.09.2016 të Ministrit të Mjedisit është ngritur komisioni për dhënien me koncesion/PPP. Ndër të tjera, ky komision ngarkohej edhe me detyrën e hartimit dhe detajimit të studimit të fizibilitetit. Ky i fundit tregon nëse³³:

- 1- projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm, dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktor;
- 2- projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;
- 3- projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;
- 4- dhënia e kontratës me koncesion/PPP është ekonomikisht më e favorshme se dhënia e saj me prokurim publik.

Përmes rezultateve të studimit të fizibilitetit, Autoriteti Kontraktues vendos nëse projekti i shqyrtuar mund të zbatohet ose jo.

Më tej, projektet që kanë nevojë për mbështetje financiare kërkojnë një miratim paraprak nga Ministria e Financave (sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë), në lidhje me përballueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal³⁴. Autoriteti Kontraktues dorëzon studimin e fizibilitetit dhe projekt-kontratën pranë Ministrisë së Financave³⁵. Këto kërkesa të ligjit janë specifikuar më në detaj në VKM nr.575, përkatësisht në nenin 17/1 dhe nenin 19 të këtij vendimi³⁶. Në rastin objekt auditimi, Ministria e Mjedisit (sot MTM) ka dërguar pranë Ministrisë së Financave (sot MFE) kërkesën për miratim paraprak me anë të shkresës nr. 5474/5 prot, datë 28.09.2016. Konstatohet që në momentin e dërgimit të kësaj kërkesë, komisioni përkatës ishte ende në procesin e hartimit të studimit të fizibilitetit dhe draft kontratës së koncesionit. Kështu, pranë MF u dërgua vetëm një version jo përfundimtar i studimit të fizibilitetit dhe i pashoqëruar me draft-kontratën, duke pretenduar se do të dërgoheshin sapo të ishin finalizuar. Në shkresën në fjalë nuk citohet arsyeja se pse AK nuk ka pritur përfundimin e hartimit të dokumenteve të kërkuara nga legjislati në fuqi, përpara se të kërkonte miratimin e Ministrisë së Financave.

Kjo e fundit ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 13118/1 prot, 17.10.2016, me anë të së cilës refuzon të shprehet për projektin, për aq kohë sa nuk janë plotësuar kushtet, kriteret dhe

³² Neni 13/3 i VKM nr. 575, datë 10.07.2013

³³ Neni 13/4 i VKM nr. 575, datë 10.07.2013

³⁴ Neni 42 i Ligjit 125/2013

³⁵ Id.

³⁶ Neni 17/1 - Projektet e koncesione/PPP-ve që kërkojnë mbështetje financiare dorëzohen në Ministrinë e Financave për miratim, pavarësisht modelit të parashikuar të koncesionit/PPP-së dhe mënyrës, në të cilën ato janë nisur, d.m.th. si propozim i kërkuar apo i pakërkuar.

Neni 19 - Kërkesa për miratimin e Ministrisë së Financave shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) studimin e fizibilitetit dhe anekset shoqëruese, përfshirë një matricë të alokimit të riskut dhe Krahasesin e Sektorit Publik (KSP), si dhe projekt kontratën dhe anekset shoqëruese;

dokumentacioni i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Ministria e Mjedisit ka ridërguar kërkesën për miratim më datë 27.12.2016, ku theksohet se ka përfunduar procesin e hartimit të studimit të fizibilitetit dhe draft-kontratës koncesionare³⁷. Nëpërmjet përgjigjes së saj në 23.01.2017³⁸, Ministria e Financave vëren se dokumentacioni i paraqitur përmbush kërkesat formalo-juridike të legjislacionit, megjithatë parashtrihen edhe disa vërejtje si më poshtë:

- Edhe pse Ministria e Mjedisit thekson se projekti i paraqitur si koncesion/PPP realizon vlerën më të mirë për para, krahasuar me procedurën tradicionale të prokurimit publik, nuk e ka argumentuar në mënyrë të qartë këtë analizë;
- Nuk është kryer një analizë ndjeshmërie në bazë të skenarëve të ndryshëm (optimist, bazë, pesimist);
- Nuk del qartë se kush do të përballojë kostot e shpronësimeve për pronat private që ndodhen në gjurmën e projektit; Megjithatë, grupi i auditimit ka konstatuar se tek analiza e riskut në studimin e fizibilitetit (risku i vendndodhjes) është përcaktuar se është koncesionari ai që do të mbulojë shpenzimet për kompensimet sipas matjeve të bëra.
- Pasaktësi në llogaritjen e normës së kthimit të investimit (IRR) dhe vlerës aktuale neto të të projektit (NPV).

Në aspektin buxhetor, Ministria e Financave ka konstatuar se projekti koncesionar nuk rezulton i planifikuar brenda tavaneve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Mjedisit, duke e përcaktuar këtë si parakusht për dhënien e miratimit paraprak nga ana e saj. MF (sot MFE) ka dalë në këtë përfundim pasi ka konstatuar angazhimin e qeverisë për të mbuluar tërësisht në katër vitet e para dhe më pas pjesërisht tarifën që duhet të paguajnë njësitet e qeverisjes vendore në favor të koncesionarit gjatë 30 viteve të projektit; ndërsa MM (sot MTM) theksonte në relacionet e saj se óvetë procedura koncesionare nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit pas kemi të bëjmë tërësisht me një investim privatô. Krahas kësaj Ministria parashtronte edhe se investitori kishte kapitalet e mjaftueshme cash, për të mbuluar të gjithë investimin, megjithatë nuk konstatohet ndonjë dokument provues në lidhje me këtë.

Nga dokumentacioni i disponuar nga grupi i auditimit nuk gjenden komunikime të mëtejshme ndërmjet dy ministrive, në lidhje me marrjen e miratimit paraprak për projektin.

Gjetje nga auditimi:

1. Direktiva 2008/98/KE dhe VKM nr. 418, datë 25.06.2014 óPër grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burimô, detyrojnë NJVV-të për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, ku në fakt asnjë njësi në Shqipëri nuk e zhvillon këtë proces.
2. Fokusi i Ministrisë së Mjedisit është zhvendosur drejt incineratorëve/metodave të fundit në hierarki, ndonëse nuk është arritur progres në lidhje me objektivat për riciklimin (apo R-të e tjera). Kjo zhvendosje e fokusit drejt impianteve të incinerimit nuk shkon në të njëjtin drejtim me frymën e Strategjisë së Menaxhimit të Mbetjeve, standardeve dhe legjislacionit, të cilat promovojnë fokusimin drejt parandalimit dhe riciklimit. Ministria e Mjedisit (si Autoritet Kontraktues) ka nënshkruar kontratën koncesionare për ndërtimin e incineratorit të Tiranës, ndërsa paralelisht ushtronte edhe projektin me JICA (Japan International Cooperation Agency), i cili fokusohet pikërisht në minimizimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve. Për sa më sipër, Ministria nuk ka qenë e qartë për politikat e ndjekura në menaxhimin e mbetjeve sa i takon hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve.
3. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve e thekson në mënyrë të qartë faktin që asgjësimi është mënyra e fundit për t'u përdorur dhe mund të përdoret vetëm në rastet kur mënyrat e tjera të hierarkisë nuk mund të jenë të zbatueshme. Nga auditimi nuk rezulton që Ministria e Mjedisit (sot MTM) të ketë zhvilluar analiza të detajuara, të ketë negociuar me

³⁷ Shkresa 5474/20 prot, datë 27.12.2016

³⁸ Shkresa 13188/3 prot, datë 23.01.2017

- publikun/palë interesi apo të ketë marrë në konsideratë përdorimin e metodave të tjera të trajtimit të mbetjeve (më të favorizuara nga hierarkia).
4. Kostot për ndërtimin e incineratorëve të rinj, si dhe funksionimi, mirëmbajtja dhe operimi i tyre në mënyrën e duhur, janë një investim shumë i madh. Ata kushtojnë shumë për tu ndërtuar dhe për të funksionuar, krahasuar me format e tjera të menaxhimit të mbetjeve.
 5. Në dokumentet e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit nga MTM, mungon propozimi i pakërkuar i paraqitur nga operatori dhe raporti përmbledhës në lidhje me të.
 6. Pranë Ministrisë së Financave (sot MFE) u dërgua nga Autoriteti Kontraktor vetëm një version jo përfundimtar i studimit të fizibilitetit dhe i pashoqëruar me draft-kontratën.
 7. Në ridërgimin e kërkesës për miratim paraprak janë plotësuar kriteret formale të legjislacionit në fuqi, por megjithatë ky miratim nuk është konfirmuar nga Ministria e Financave për shkak të disa konstatimeve në aspektin buxhetor të kontratës, duke qenë se projekti koncesionar nuk rezulton i planifikuar brenda tavaneve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Mjedisit (sot MTM).
 8. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar një analizë të plotë dhe faktoriale, ku të merreshin parasysh skenarë dhe rezultate shteruese, për të përcaktuar llojin e procedurës që duhej përdorur për ndërtimin e Incineratorit të Tiranës.

Konkluzione

1. Duke qenë se kontrata koncesionare për ndërtimin e këtij objekti është nënshkruar nga Ministria e Mjedisit (si Autoritet Kontraktues), ndërsa paralelisht ushtrohej edhe projekti për minimizimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve, mund të konkludohet se drejtimit dhe politikat e këtij institucioni në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane.
2. Duke marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e audituara mund të konkludohet se procedura e planifikimit të këtij projekti ka mungesa dhe paqartësi në lidhje me propozimin paraprak të ardhur në ministri dhe konfirmimin e miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të legjislacionit të kohës.
3. Për sa më sipër, vihet re që procesi i studimit dhe planifikimit të këtij investimi është bërë i pa mbështetur në politikat strategjike të promovuara nga Ministria e Mjedisit.

Rekomandime

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njësitë e Qeverisjes vendore të marrin masa për reduktimin e sasisë së mbetjeve nëpërmjet promovimit të 3R-ve (reduktim, ripërdorim dhe riciklim), diferencimin e mbetjeve në burim dhe progresin në lidhje me objektivat e riciklimit, në përputhje me synimet strategjike të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesave/standardeve të Bashkimit Europian, duke mos trajtuar si zgjidhje me përparësi impiantet e incenerimit apo metodat e tjera në fund të hierarkisë së mbetjeve.

Në vazhdimësi

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa që në procedurat e prokurimeve të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat formale të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe koncesionet/PPP.

Në vazhdimësi

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zhvillimin e procedurave në vazhdimësi, të kryej analiza të detajuara duke vlerësuar faktorët e riskut dhe studiuar procedurën më të përshtatshme, për ndërtimin e veprave infrastrukturore në fushën e mjedisit.

Në vazhdimësi

4.1.2 A ka qenë i dakordësuar nga të gjitha palët e përfshira realizimi i këtij investimi?

Për të përshkruar situatën e zhvillimit të procedurës së këtij investimi, në funksion të një analize të detajuar mbi eficiencën e vendimmarrjes, grupi i auditimit ka shqyrtuar një set evidencash zyrtare të komunikimeve ndërinstytucionale të siguruara jo vetëm nga subjektet nën auditim, por dhe nga palët të tjera të interesit të lidhura ngushtësisht me objektin e investimit atë të Incineratorit të Tiranës, siç janë shoqatat mjedisore.

I ndodhur në kushtet e një investimi nën termat e tipit koncesion, autoriteti kontraktor legjitimohet të zbatojë aktet ligjore dhe rregullatore që vendi ofron për zhvillimin e investimeve të këtij lloji. Si e tillë për periudhën e zhvillimit të procedurave për dhënien me koncesion/PPP ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, autoriteti kontraktor dhe palët e përfshira për realizimin e investimit, i nënshtrohen detyrimeve që përcakton Ligji nr. 125/2013 óPër koncesionet dhe partneritetin publik privató, i ndryshuar si dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/pppó.

MTM e ndodhur në kushtet e pritjes së óPropozimit të pakërkuaró, prej operatorit ekonomik/koncesionarit, angazhohet të nisi fazën përgatitore për dhënien e një kontrate me koncesion/ppp, vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjes dhe trajtimit të propozimeve të pakërkua, si dhe procedurën dhe kriteret për vlerësimin dhe miratimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat që kërkojnë mbështetje financiare në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat³⁹. Këto procedura iniciojnë me ngritjen e Komisionit të koncesionit/ppp nga AK dhe Njësia e Trajtimit të Koncesioneve/ppp⁴⁰. Ky komision përvec pjesëmarrjes së ATRAKO (Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve), fushëveprimtaria e së cilës lidhet ngushtësisht me procesin, fton për pjesëmarrje anëtarë të institucioneve të tjera veprimtaria e së cilave lidhet me objektin dhe karakteristikat e koncesionit/ppp. Në të njëjtën kohë pjesëmarrja e anëtarëve në këtë komision, përcakton edhe palët e përfshira për realizimin me suksese të këtij investimi.

Për këtë qëllim Ministria e Mjedisit ka derguar shkresën nr.5474, datë 24.08.2016 "Për plotësimin e anëtarëve të Komisionit të Koncesionit me objekt "Për dhënien me Koncesion/PPP ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë" pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, ATRAKO dhe Bashkisë Tiranë, të cilët në korespondencat shkresore caktojnë anëtarët konkretisht, MEI një anëtar, ATRAKO dy anëtarë dhe Bashkia Tiranë dy anëtarë. Me Urdhërin e Ministrit të Mjedisit óPër ngritjen e komisionit ó nr.169, datë 05.09.2016, specifikohet edhe veprimtaria e tij si:

- Hartimin e studimit të fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat;
- Për përcaktimin e procedurës të zbatueshme për dhënien e koncesionit partneritetit publik privat dhe hartimin e dokumentacionit të tenderit;
- Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranura dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar;
- Formulimin dhe propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre;
- Kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkojnë për zbatimin e procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Për të qartësuar opinionin publik me qëllim bërjen të kuptueshëm për taksapaguesin final të materialit të këtij raporti, si dhe gjenerimit të përgjigjes mbi pyetjen e auditimit, grupi i auditimit nisur nga evidencat dhe dokumentacioni shkresor ka listuar palët e interesit si më poshtë:

- Ministria e Financës dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

³⁹ VKM nr. 575, datë 10.7.2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privató, i ndryshuar, neni 1;

⁴⁰ Ligji nr. 125/2013 óPër koncesionet dhe partneritetin publik privató, i ndryshuar, neni 18;

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes;
- Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë;
- Qarku Tiranë;
- Shoqata mjedisore në vend me fokus mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane,

të cilat në zbatim të legjislacionit në fuqi⁴¹, duhet të japin në mënyrë shkresore për AK miratimin paraprak të këtij projekti, përpara shpalljes së procedurës për dhënien me koncesion, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit hartuar nga komisioni i dhënies me koncesion të AK. Në këtë studim bëhet një përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve të projektit, implementimi i tij, situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Tiranës, objektivat e projektit të propozuar, situata e prodhimit të mbetjeve në këtë territor, përshkrimi i projekti, teknologjia dhe karakteristikat e impjanit që do përdoret, analiza SWOT dhe pagesat takuese për zhvillimin e koncesionit.

Për Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë

Neni 42 i ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar, ka parashikuar që: "Projekti që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave, në lidhje me përbalueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e AK ka nisur komunikimin shkresor me MFE për miratimin paraprak të situatës ekonomiko-financiare të projektit me shkresën nr. 5474/5, datë 28.09.2016 ku ndër argumentat financiar të përmendur, listohen:

- Kosto e shpronësimit të një pjese të sipërfaqes që do të përdoret nga impjanti, pasi zona e propozuar për realizimin e impiantit është e barabartë me rreth 120 hektarë (1,200,000 m²), pjesë të të cilës janë pronë private në 39.9% të sipërfaqes dhe 60.1% të saj është pronë shtet, pjesë e Bashkisë Tiranë, Njesia Administrative Vaqarr, Zona Kadastrale 3321.
- Është menduar, që për realizimin e projektit, subjekti koncesionar i cili do të shpallet fitues dhe do të nënshkruajë kontratën koncesionare, përveç tarifës bazë të ATRAKO-s do të paguajë edhe një fee koncesionare rreth 3% të të ardhurave të projektit.
- Përsa i përket blerjes së energjisë, që është specifikuar të jetë nga KESH, citohet se, referuar legjislacionit të fuqi, përkatësisht ligji 138/2013 "Per burimet e energjise se rinovueshme", neni 14 "Detyrimi per te blere energji elektrike te prodhuar nga burime te rinovueshme energjie", KESH ka detyrimin për të blerë energjitë e rinovueshme, ku futet kjo lloj energjie.

Në përgjigje të kësaj shkrese MFE kthen përgjigje me nr.13118/1, datë 17.10.2016 duke argumentuar *se nuk mund të shprehet* për këtë projekt koncesionar/PPP, për sa kohë që nuk janë plotësuar kushtet, kriteret dhe dokumentacioni i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", konkretisht studimi i fizibilitetit është jopërfundimtar dhe i pashoqëruar me draft-kontratën.

Në vazhdimësi të komunikimit, MTM me shkresën nr.5474/8, datë 07.11.2016 dërgon për vendim⁴² projektvendimin e KM dhe relacionin shpjegues "Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion". Ky projektvendim në kuadër të marrëdhëniet midis palëve citon miratimin e bonusit prej 8% të pikëve për I. E. B. V shpk për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë. MFE me shkresën kthim përgjigje nr.15402/1, datë 30.11.2016 sqaron se: *onë relacionin që shoqëron projekt-vendimin nëse do të ketë ofertues fitues dhe kontratë të lidhur, nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit, pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat, madje*

⁴¹ Ibid neni 17, pika 1 dhe pika 2;

Ibid neni 42, pika 1 dhe pika 2;

⁴² Ibid neni 25, pika 6;

buxhetit të shtetit do t'i shtohet vlera e Fee-së koncesionare që do të detyrohet të paguajë subjekti". Ndërsa, po në përmbajtje të relacionit shpjegohet se, zgjidhja e propozuar në këtë projekt ku Bashkitë, pjesë e qarkut do të paguajnë tarifën e depozitimit mbi bazë të sasisë së mbetjeve që do të gjenerojnë, rezulton një zgjidhje optimale dhe e bën atë që quhet partneritet publik privat. Si e tillë për MFE nuk del e qartë nëse Bashkitë e Qarkut Tiranë e kanë të parashikuar mbulimin e tarifës së depozitimit mbi bazë të sasisë së mbetjeve, në buxhetin e tyre afatmesem 2017-2019. Kjo për faktin se MFE vlerëson dhe miraton paraprakisht, të gjitha projektet Koncesionare Partneriteti Publik Privat, si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale⁴³. Në shqyrtim të argumentave MFE sqaron se në rast pranimit të një propozimi të pakërkuar, propozuesit i jepet një % për rezultatin tekniko-financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum prej 10% të pikëve totale të garës. Këshilli i Ministrave, në bazë të propozimit të autoritetit kontraktues, miraton me vendim pikët që i jepen si për propozuesin. Si e tillë MFE sugjeron që përpara dhënies së miratimit të bonusit, nëse rezulton që projekti i Koncesionit /PPP, kërkon mbështetje financiare, në zbatim të nenit 42 të ligjit 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" të ndryshuar, MTM duhet të marri domosdoshmërisht miratimin paraprak nga Ministria e Financave, përpara shpalljes së procedurës.

Në këtë moment ndodhur në intervalin e komunikimeve zyrtare për marrjen e aprovimit nga palët e interesit, Ministria e Mjedisit në funksion të miratimit të bonusit për kompaninë óI. E. B.Vô shpk i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave me shkresën nr.5474/15, datë 05.12.2016 óDërgim për shqyrtim e miratim një projektvendimó. Kërkesë kjo e cila përfundon me miratimin e VKM nr.855, datë 7.12.2016 óPër miratimin e bonusit prej 8% të pikëve, që i jepet shoqërisë óI. E. B.Vô shpk për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse.

Në kuadër të marrjes së miratimit nga MFE, përpara shpalljes së procedurës së dhënies me Koncesion/PPP në lidhje me përballueshmërinë, qëndrueshmërinë, dhe fizibilitetin fiskal të projektit, MM i drejtohet MFE me shkresën óRidërgim kërkesë për miratimó nr. 5474/20, datë 27.12.2016, shoqëruan me *Studimin e Fizibilitetit*, i cili është një përmbledhje e të ardhurave dhe shpenzimeve të projektit, material i cili është arsyetuar për vendimin e marrë nga komisioni i dhënies me koncesion.

Për këtë komunikim MFE i përgjigjet MM me shkresën 5474/21, datë 24.01.2017 ku kërkon sqarime dhe argumenta përkatës lidhur me disa kontradikta të konstatuara si mëposhtë:

Në aspektin juridiko-formal:

- Studimi i fizibilitetit argumenton se KSP(Krahasuesi i Sektorit Publik) paraqet vlerën më të mirë për para për variantin Koncesion/PPP me vlerë 128,090,000 Euro, krahasuar me metodën tradicionale të prokurimit publik, kostoja totale e të cilit do të jetë 134.800.000 Euro. Por studimi nuk ofron argumentim të plotë dhe të qartë në lidhje me bazën krahasimore të përdorur midis dy modeleve të paraqitura.
- Në lidhje me riskun e mosplotësimit të sasisë së parashikuar të mbetjeve për t'u trajtuar nga koncesionari dhe përballimin e këtyre kostove nga Buxheti i Shtetit, nuk është kryer një analizë ndjeshmërie në bazë të skenarëve (optimist, bazë, pesimist), por është konsideruar vetëm skenari pesimist, ku edhe për këtë skenar nuk është bërë një vlerësim sasior me qëllim përcaktimin e pagesesave shtesë që do të duhet t'i bëhen koncesionarit.
- Në lidhje me statusin ligjor të tokës, në Studimin e fizibilitetit sqarohet se në tokën në të cilën do të ndërtohet impianti i riciklimit, Shteti është pronar për 60.1% të sipërfaqes, kurse pjesa tjetër prej 39.9% është pronë private, e cila do të shpronësohet me një kosto totale prej 214 milionë lekë, kosto e cila nuk del qartë se nga do të përballohet. Nëse kjo kosto do të përballohet nga Buxheti i Shtetit, duhet të garantohet dhe futet në përlllogaritje krahas

⁴³ Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise", nenit 4/2;

mbështetjes buxhetore, duke përcaktuar qartësisht përballimin e saj brenda fondeve buxhetore të miratuara të institucionit përgjegjës.

Në aspektin buxhetor:

- Projekti koncesionar/PPP i paraqitur nuk rezulton i planifikuar brenda tavanëve buxhetore të miratuara për MM, parakusht i vendosur në nenin 22 të VKM-së nr.575/2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion ppp", me qëllim procedimin e mëtejshëm për miratimin paraprak të projektit. Kjo pasi konstatohet se në studimin e fizibilitetit parashikohet që pagesa totale për një kohëzgjatje të projektit prej 30 vjetësh e mbulohet përkatësisht nga: Qeveria Shqiptare në masën 130,883,750 Euro pa TVSH; Nga buxheti i bashkive në masën 91,784,500 Euro pa TVSH, për të cilat nuk ka ndonjë konfirmim zyrtar në lidhje me marrjen përsipër të këtij angazhimi buxhetor.
- Në këtë kontekst, referuar në relacionin shoqërues të projektaktit në paragrafin e fundit të pikës IX MM shprehet se: óVetë procedura koncesionare nëse do të ketë një ofertues fitues dhe një kontratë të lidhur, nuk do të ketë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat, madje buxhetit të shtetit do t'i shtohet vlera e Fee koncesionare që do të detyrohet të paguajë subjektiô.

Në këtë kontekst MM me shkresën nr.5474/23, datë 01.02.2017 óRidërgon kërkesën për miratim në MFEô ku bashkëlidh disa sqarime më tepër në lidhje me shpronësimin e rreth 478,800 m² tokë arë të vlerësuar me çmimin prej 448 lekë/m² që përbën kosto prej 214,502,400 lekë që do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit.

Në lidhje me projektimin e investimit jashtë tavanëve buxhetore të miratuara të MM, sqarohet se megenëse bashkitë e qarkut Tiranë, si ajo e Vorë, Kavajë, Kamëz nuk disponojnë të ardhura të mjaftueshme, për përballimin e kostove të depozitimit të mbetjeve në impjant, propozohet që këto institucione të mbështeten nga Qeveria Qendrore, ku Bashkia Tiranë do të marrë përsipër të mbulojë kostot e depozitimit për minimumi 700 ton/ditë. Po në këtë shkresë sqarohet se skenari bazë i operimit citohet se është 700 ton/ditë dhe skenari pesimist është 550-650 ton/ditë, informacion ky i cili ndryshon nga çfarë paraqitet në studimin e fizibilitetit për skenarin bazë prej 550-800 ton/ditë.

Bashkia Tiranë për vitin e parë do marri përsipër të financojë 1,000,000 Euro = me 34,365 ton/ditë mbetje dhe diferencën do e përballojë me vlerat financiare nga buxheti i vetë dhe Qeveria Qendrore.

Në përgjigje të këtij shpjegimi MFE shkresën óKthim Përgjigjeô nr.5474/24, datë 21.02.2017, sqaron se projekti koncesionar duhet detyrimisht të planifikohet brenda tavanëve buxhetore vjetore të MM të miratuara nga Kuvendi si dhe brenda tavanëve të shpenzimeve për periudhën afatmesme të miratuara me VKM⁴⁴. Gjithashtu theksohet se përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion për këtë projekt, të reflektohen të gjitha rekomandimet e bëra nga MFE nëpërmjet shkresës nr.13118/3 datë 23.02.2017. MM në përgjigje të të dhënave më sipër ridërgon për MFE me shkresën nr.5474/25, datë 21.02.2017 shpjegime mbi projektin, të cilat janë të njëjtat argumenta si ato të paraqitura më herët. Në insistim të marrjes së miratimit, MM me shkresën óRidërgim kërkesë për miratimô nr.5474/29, datë 28.03.2017 drejtuar MF, bashkëlidh miratimin e Bashkisë Tiranë (kërkuar nga MFE) dhe shprehet se është në pritje të miratimit përfundimtar nga ana e MFE për vazhdimin e procedimit ligjor mbi procedurën koncesionare.

Sipari i komunikimit zyrtar midis MFE dhe MM për marrjen e miratimit përfundimtar përmbillet me shkresën óKthim Përgjigjeô të MF me nr 13118/9, datë 06.04.2017 drejtuar MM, ku shprehet pa komente për dakortësinë e Bashkisë Tiranë, për sa kohë që Financuesi dhe përfituesi i projektit është BT, por kërkon vlerësimin me prioritet maksimal të çështjeve që lidhen me:

⁴⁴ VKM 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/pppô, i ndryshuar, nenit 22;

- Kostot buxhetore që mund të lindin si pasojë e materializimit të risqeve të ndryshimit të kursit të këmbimit dhe atij nga inflacioni, të cilat duhet të përlogariten plotësisht brenda totalit të parashikuar si mbështetje financiare për këtë projekt;
- Marrjen e miratimit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e institucionit përgjegjës për politikall në fushën e energjisë elektrike dhe pronarit të KESH sh.a për përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike (Feed in tariff);
- Marrjen e miratimit nga njësitë e qeverisjes vendore që përfshihen në këtë projekt, lidhur me përballimin prej tyre të riskut të mosplotësimit të sasisë së mbetjeve për t'u trajtuar nga koncesionari.

Gjetje nga auditimi:

9. Ministria e Mjedisit (sot MTM) në harkun e komunikimeve zyrtare me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, të iniciuara me shkresën nr. 5474/5, datë 28.09.2016 dhe përmbyllura më shkresën e MFE nr.13118/9 datë 06.04.2017, ka vazhduar procedurën mbi projektin koncesionar të Incineratorit të Tiranës, vetëm prej tejkallimeve të afateve vendimmarrëse të MFE, por pa mundur të sigurojë dakortësinë e plotë të saj, duke mos ofruar argumenta shterues të çështjeve financiare si kostot buxhetore, çmimi i energjisë apo miratimi nga NJQV të Qarkut Tiranë për projektin koncesionar në dhënien me koncesion ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.Vô shpk.
10. MTM ka vazhduar procedurën mbi projektin koncesionar të Incineratorit të Tiranës, duke anashkaluar koston e shpronësimit të sipërfaqes së nevojshme për ndërtimin e veprës së projektit rreth 478,800 m² tokë arrë të vlerësuar me çmimin prej 448 lekë/m² që përbën kosto prej 214,502,400 lekë, vlerë e cila nuk është parashikuar në tavanet buxhetore për mbështetjen e projektit nga buxheti i shtetit.

Konkluzion

4. Vijimi i procedurës në mungesë të vendimmarrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e vlerësuesit dhe miratuesit paraprakisht të gjitha projekteve koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale, pavarësisht nga modeli i parashikuar i koncesionit/PPP dhe mënyra në të cilën ato janë nisur, d.m.th., propozim i kërkuar apo i pakërkuar, konkretisht edhe në propozimin e operatori ekonomik ól. E. B.Vô shpk, për incineratorin e Tiranës, shpreh në mënyrë eksplicite papërbalueshmërinë dhe/ose paqëndrueshmërinë si edhe ndërrmarjen e angazhimeve publike që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përbalueshmërinë dhe efektivitetin e projektit.

Rekomandim

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në funksion të paraqitjes për miratim të projekteve koncesionare që sigurojnë përbalueshmëri financiare, qëndrueshmërinë e borxhit publik, implikime fiskale dhe risk të moderuar, të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimet ligjore referuar VKM 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/pppô, i ndryshuar, nenin 21, pika 3, nga pikëpamja e miratimit të projekteve të tilla strategjike dhe financiarisht të larta, jo apriori vetëm si shkak i tejkallime të afateve vendimmarrëse.

Brenda muajit Qershor 2022

Për Ministrinë e Drejtësisë

Neni 3, pika 4/j e VKM 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/pppô, i ndryshuar, ka parashikuar përgatitjen e raportit përmbledhës të Komisionit të

koncesionit/PPP mbi propozimin e pakërkuar, si dhe propozimin në ministritë e linjës⁴⁵ për dhënien e pikëve në bazë të rezultateve teknike dhe financiare të studimit të fizibilitetit të parashtruar. Si e tillë Ministria e Mjedisit i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë me shkresës nr.5474/8, datë 07.11.2016 për mendim projektvendimi mbi miratimin e bonusit, në përgjigje të së cilës MD me shkresën 0Kthim përgjigje nr.7358/1, datë 15.11.2016 shpreh mendimin se:

Në aspektin ligjor:

- Nisur nga impakti që ka për qytetarët ky projekt duke qenë se përbën një çështje sensitive bazuar në zhvillimet e kohëve të fundit në këtë fushë, duhet t'i ishte nënshtruar një procesi konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit. Për më tepër, bazuar në rregullat për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, duhej të ishte vënë në dispozicion informacioni dhe studimi i fizibilitetit, ku të mund të evidentohet qartë se projekti jo vetëm përmbush kërkesat ligjore, por edhe që nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor. Transparenca e analizës së ndikimit mjedisor dhe social, e kryer në funksion të investimit të planifikuar, si pjesë e studimit të fizibilitetit, shërben për të bërë të mundur një vlerësim paraprak të aspekteve të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së propozimit.

Në aspektin teknik:

- Sa i përket projektvendimit të propozuar, pika 6 e nenit 25 të ligjit nr. 125, datë 25.04.2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, e përdorur si dispozitë autorizuese për nxjerrjen e këtij projektvendimi parashikon se: "Propozuesit i jepet një për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum 10 % të pikëve totale të garës". Nisur nga interpretimi literal i kësaj dispozite si dhe nga analiza në tërësi e nenit 25 të ligjit nr. 125/2013, i cili trajton propozimet e pakërkua, konstatojmë se në asnjë pikë të tij nuk përmendet apo autorizohet shprehimisht Këshilli i Ministrave për miratimin e dhënies së bonusit për subjektin i cili ka paraqitur një propozim të pakërkuar, i cili nuk vjen në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues.
- Pika 7 e këtij neni parashikon se Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua, pa individualizuar apo përcaktuar trajtimin e një rasti konkret të propozimit të pakërkuar. Referuar edhe nenit 118 të Kushtetutës, ku përcaktohet se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte, çdo nismë tjetër e ndryshme do të çonte në rënien ndesh me këto rregulla kushtetuese dhe ligjore.

Në përfundim duke marrë në konsideratë gjetjet e mësipërme, MD propozon rivlerësimin e nismes në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për koncesionet/partneritetin publik privat si dhe respektimin e procedurës së përcaktuar nga ky legjislacion, sa i përket veçanërisht vlerësimit objektiv të asaj pjese të studimit të fizibilitetit, që identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë, por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht; si dhe aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti. ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

Ministria e Mjedisit në përgjigje të palës të shprehur me rezerva ka ridërguar për mendim shkresën nr.5474/14 datë 25.11.2016 në Ministrinë e Drejtësisë ku në qëndrimin e saj sqaron se:

- Akti nuk bën pjesë tek aktet që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, pasi vetëm projektligjet referuar bazës ligjore në fuqi, i nënshtrohen këtij procesi, për më tepër akti i propozuar nuk bën gjë tjetër përveçse i jep pikavarazh favorizues subjektit që ka bërë propozimin e pakërkuar për këtë procedurë, në rast se ky do të marri pjesë duke ofruar një

⁴⁵Ligji nr. 125, datë 25.04.2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, neni 25, pika 6

ofertë ekonomike në procedurë dhe do të kualifikohet në këtë procedurë pas publikimit të saj online. Konsultimi me publikun për projektin e jo aktin, do të bëhet në një fazë më të vonët pasi realizimi i projektit do të kalojë mbi procedurat e vlerësimit mjedisor. Si e tillë, kërkesa për të bërë konsultim me publikun për aktin është e pavënd duke partur parasysh se akti i propozuar ka karakter individual, pra i shtrin efektet e tij juridike vetëm mbi një shoqëri të mirëpërcaktuar dhe nuk do të kishte me kë ta bëjë edhe konsultimin duke qënë me mungojnë fizikisht dhe ligjërisht grupet e interesit.

- Bazë ligjore⁴⁶ nuk citon në asnjë rast që projektvendimi i miratimit të it duhet te shoqërohet nga studimi i fizibilitetit që ministritë që japin mendim të njihen me të për të vlerësuar nëse i përmbush apo jo kushtet ky studim për t'u vlerësuar me pikë. Vetëm Komisioni i ngritur me urdhër të Ministrit që e ka brënda fushës së përgjegjësisë koncesionin, ka të drejtën eskuzive të vlerësojë këtë studim, por në asnjë rast ta bëjë publike apo t'ia delegojë institucioneve të tjera vlerësimin e tij.
- Në këndvështrim të efekteve të projektit në lidhje me përbërësit mjedisorë, aspektet sociale etj, në këndvështrimin e MM kapërcen fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

Gjetje nga auditimi:

11. Ministria e Mjedisit sot MTM, nuk i është nënshtruar një procesi konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, përpara propozimit të projekt vendimit për dhënien e pikëve drejtuar Ministrisë së Drejtësisë (MD). Ky projekt vendim është ofruar në mungesë të transparencës dhe informacionit të studimit të fizibilitetit për MD.

Konkluzion

5. Mungesa e një procesi konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit për nisma sensitive dhe impakt tek qytetarët, ka sjellë refuzimin e mendimit njëherësh aprovimit të projektit koncesionar për dhënien me koncesion ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.Vô shpk nga Ministria e Drejtësisë. Mos respektimi i rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, ku duhej të ishte vënë në dispozicion informacioni dhe studimi i fizibilitetit, nuk evidenton qartësisht dhe zyrtarisht nëse projekti përmbush kërkesat ligjore dhe nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor.

Rekomandim

5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për këtë projekt dhe në vijimësi, të sigurojë për ministritë e linjës dhe grupet e interesit transparencë të plotë të analizës së ndikimit mjedisor dhe social, në funksion të investimit të planifikuar, si pjesë e studimit të fizibilitetit, për të bërë të mundur një vlerësim paraprak të aspekteve të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së propozimit, që identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë, por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht; si dhe aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti. ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

Në vazhdimësi

⁴⁶ pika 6 e nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar; VKM 575 date 10.07.2013 "Per miratimin e rregullave per identifikimin, vleresimin dhe dhenien me koncesion/PPPô;

Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Neni 3, pika 4/j e VKM 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/PPPó, i ndryshuar, ka parashikuar përgatitjen e raportit përmbledhës të Komisionit të koncesionit/PPP mbi propozimin e pakërkuar, si dhe propozimin në ministritë e linjës⁴⁷ për dhënien e pikëve në bazë të rezultateve teknike dhe financiare të studimit të fizibilitetit të parashtruar. Si e tillë Ministria e Mjedisit i drejtohet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me shkresës nr.5474/8, datë 07.11.2016 óPër mendim projektvendimi mbi miratimin e bonusitó, në përgjigje të së cilës MEI me shkresën óMendim për projektvendiminó nr.6695/1, datë 17.11.2016 shprehet se:

12. Si kompetencë e AK për propozimin e dhënien së bonusit për propozuesin e koncesionit, deri në 10% të pikëve totale të garës parimisht është dakord.

Në përgjigje të shkresës së MM óKërkesë për miratimó nr.5474/31 datë 11.04.2017 drejtuar MEI si kërkesë e MF mbi dhënien e miratimit në cilësinë e institucionit përgjegjës për politikën në fushën e energjisë elektrike dhe si pronar i KESH-it, për përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike njohur ndryshe si ófeed in tariffó, MEI me shkresën óKthim përgjigjeó 2221/1 datë 26.05.2017 sqaron paraqitjen e kërkesës më sipër në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë Entit Rregullator të Energjisë i cili në zbatim të ligjit nr.43/2015óPër sektorin e energjisë elektrikeó, është institucioni përgjegjës për trajtimin e tarifave.

Gjetje nga auditimi:

12. Ministria e Mjedisit sot MTM në përfundim të korrespondencave zyrtare për miratimin paraprak të projektit koncesionar nga MFE, nuk ka respektuar rekomandimet e kësaj të fundit, duke mos vijuar komunikimin zyrtar me MIE, mbi miratimin prej saj në cilësinë e institucionit përgjegjës për politikën në fushën e energjisë elektrike dhe si pronar i KESH-it, për përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike njohur ndryshe si ófeed in tariffó.

Konkluzion

6. Mungesa e përgjigjeve zyrtare dhe dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e të cilave lidhet ngushtësisht më objektin e projektit koncesionar, devijon procesin e rregullt të miratimit mbi këto nisma duke sjellë mungesë efieencie dhe identifikim të risqeve potencialë të shoqëruar me kosto financiare për buxhetin e shtetit.

Rekomandim

6. Ministria e Mjedisit sot MTM, të sigurojë vazhdimet e komunikimeve zyrtare me institucionet përgjegjëse si MIE dhe KESH, fushë-veprimtaria e të cilave lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar, deri në marrjen e përgjigjeve përfundimtare mbi risqet e identifikuara për projektin e Incineratorit të Tiranës.

Menjëherë pas marrjes së këtij Raporti Përfundimtar

Për Ministrinë e Shtetit dhe Marrëdhënieve me Parlamentin

Në përgjigje të shkresës 5474/8 datë 07.11.2016 të MM óPër mendim projektvendimi mbi miratimin e bonusitó drejtuar Ministrisë së Shtetit për Marrëdhënieve me Parlamentin, kjo e fundit me shkresën óDhënie mendimió nr.6490/1, datë 15.11.2016 komenton se:

- Sipas projektvendimit, bonusin e fiton shoqëria "I. E. B.V" shpk, për të cilën pavarësisht kërkimit disa herë si me anë të emrit të shoqërisë ashtu edhe me emër aksioneri, nuk është mundur të gjendet si shoqëri e regjistruar në QKB, të dhëna që MM duhet ti vendosi në dispozicion për të dalë qartazi që kompania e ka kapitain e nevojshëm financiar për një investim të tillë.

⁴⁷Ligji nr. 125, datë 25.04.2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, neni 25, pika 6

- Është e vlefshme që, nga studimi dhe biznesplan i paraqitur nga biznesi, të citohen në relacion aspektet pozitive dhe negative, me llogaritje të përafërta, të impaktit që do të ketë projekti në ambient, në zonë etj.
- Përsa i përket trajtimit të ujrave të ndotura, ekziston tashmë një grant nga Banka e Japonisë për ndërtimin e terminalit të përpunimit të ujërave të ndotura për qytetin e Tiranës. Rekomandojmë që të shpjegohet në relacion që ky projekt nuk mbivendoset me projekte të tjera për të cilat punohet për t'u implementuar.

Ministria e Mjedisit për palët të cilat janë shprehur me rezerva ka vepruar duke ridërguar për mendim konkretisht shkresën nr.5474/14 datë 25.11.2016, ku bën me dije se në referim të rekomandimeve të bëra nga kjo ministri, janë bërë sqarimet përkatëse në relacionin bashkëlidhur aktit të dërguar.

Gjetje nga auditimi:

13. Ministria e Mjedisit në përfundim të korrespondencave zyrtare për mendim projektvendimi mbi miratimin e bonusit, nuk ka siguruar dakordësinë përfundimtare të MSHMP-së lidhur me projektin koncesionar për dhënien me koncesion ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.Vó.

Konkluzion

7. Mungesa e dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e të cilave lidhet ngushtësisht më objektin e projektit koncesionar, devijon procesin e rregullt të miratimit mbi këto nisma duke sjellë mungesë eficiense dhe identifikim të risqeve potencialë.

Për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Në përgjigje të shkresës 5474/8 datë 07.11.2016 të MM óPër mendim projektvendimi mbi miratimin e bonusit drejtuar MZHETTS, kjo e fundit me shkresën óDhënie mendimi nr.8916/1, datë 21.11.2016 shprehet në parim dakort, pasi Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, ka qenë pjesë e komisionit të koncensionit, ne cilesine e anëtarit.

Për Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

Ministrisë së Mjedisit me shkresën óKërkesë për Informacion nr.5474/4, datë 27.09.2016 i drejtohet zyrës Rajonale të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në të cilën kërkohet vertetimi i statusit juridik të pronës me sipërfaqe 120 ha me qëllim vazhdimin e procedurave të projektimit që MM dhe Bashkia Tiranë po projektojnë në NJA Kashar zona kadastrale 3321.

ZVRPP Tiranë, me shkresën nr.30753/1 datë 27.10.2016 i kthen përgjigje Ministrisë së Mjedisit në lidhje me informacionin e kërkuar për pasurinë e cituar në shkresën nr.5474/4 datë 27.09.2016, ku shprehet se ZVPP nuk procedon me koordinata gjeografike, por me indekse të hartës treguese në shkallë 1:2500 për zonat rurale. Si e tillë kërkon saktësim të dhënash mbi pasurinë.

Në kuadër të bashkëpunimit më ZVPP Ministria e Mjedisit me shkresën óRikërkesë për informacion nr. 5474/9, datë 09.11.2016 i drejtohet ZRRPP Tiranë, ku pasi i vë në dijeni për projektin e ri në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, rikërkon informacion të saktë në lidhje me statusin juridik të pronës referuar hartës, në përgjigje të kësaj shkrese Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë lidhur me kërkesën për informacion të pasurisë në ZK.3321, bën me dije se: Zonat urbane të cituara nuk janë të azhornuara në sistemin e ZVRPP-së dhe për këtë arsye nuk mund të identifikojnë dot të gjitha pasuritë e përfshira në konturin me ngjyrë të shkresës tuaj.

Gjetje nga auditimi:

14. Ministria e Mjedisit në përfundim të korrespondencave zyrtare me ZVRPP Tiranë për informacion mbi pronën ku do të investohet, ka vazhduar procedurën edhe pse nuk ka mundur të sigurojë informacion zyrtar mbi statusin juridik të pronës, duke mos ezauruar të gjithë etapat dhe fazat e marrjes së përgjigjes përfundimtare për pronësinë.

Konkluzion

8. Mungesa e informacionit paraprak mbi statusin juridik të pronës ku do të investohet projekti koncesionar për ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend-depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.Vô, sjell rritje potenciale të riskut financiar dhe atij ligjor, kryesisht në identifikimin jo të saktë të barrës së shpronësimeve.

Rekomandim

7. MTM në projektet e ardhshme të sigurojë informacion të detajuar mbi statusin juridik të pronave, ku ka projekte investimi, për të saktësuar riskun financiar të investimit lidhur me barrën e shpronësimeve.

Në vazhdimësi

Për Qarkun Tiranë

MM si pasojë e kërkesës që ka bërë MF në përgjigjen e saj për miratimin e projektit Koncesionar, i drejtohet me shkresën óKërkesë për miratimin e vazhdimin të procedurave koncesionareó nr.5474/26, datë 28.02.2017 Bashkisë Tiranë ku i bën me dije se : është i nevojshëm miratimi me shkrim i Bashkisë Tiranë mbi vazhdimin e procedurave koncesionare referuar modelit financiar të propozuar në studimin e fizibilitetit.

Bashkia Tiranë me shkresën óKthim Përgjigjeó nr. 5474/28, datë 27.03.2017 i drejtohet MM duke bërë me dije se: Bashkia Tiranë shprehet parimisht dakort, për sa i përket rolit të saj, referuar Studimit të Fizibilitetit të paraqitur nga MM. Sqarojmë se Bashkia Tiranë është anëtare e Komisionit të Koncesionit me objekt "Për dhënien me Koncesion/PPP ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë" me dy anëtarë njëkohësisht edhe pjesëmarrëse në miratimin e Studimit të Fizibilitetit të këtij projekti. Si e tillë MM duhet të merrte miratimin e bashkive të tjera të Qarkut Tiranë në këtë projekt, kjo sepse vetë Studimi i Fizibilitetit përcakton domosdoshmërinë e sigurimit të sasive të mbetjeve për të realizuar me efektivitet projektin dhe siguruar benefitet për të cilat është rënë dakort në studim.

Gjetje nga auditimi:

15. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nuk ka respektuar në mënyrë rigoroze kërkesën e MFE-së për marrjen e miratimit me shkrim mbi vazhdimin e procedurave koncesionare, duke siguruar dakordësinë vetëm të Bashkisë Tiranë, por jo të bashkive të tjera përbërëse të Qarku Tiranë të cilat janë të përfshira në Studimin e Fizibilitetit.

Konkluzion

9. Mungesa e dakordësisë me shkrim e bashkive të tjera të Qarkut Tiranë përveç Bashkisë Tiranë, provokon në të ardhmen kosto financiare për këto bashki, mos përfshirja e të cilave mbi këtë argument do të sjellë mungesë efektiviteti për realizimin e projektit të Incineratorit të Tiranës.

Rekomandim

8. Autoriteti Kontraktor - Ministria e Mjedisit dhe sot MIE, të sigurojnë dakordësinë apo refuzimi me shkrim të bashkive të Qarkut Tiranë pasi të jenë analizuar efektet financiare, fiskale, mjedisore dhe sociale të përballimit të këtij projekti koncesionar nga këto bashki.

Për Shoqatat mjedisore në vend me fokus mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane

Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim, për të zyrtarizuar qëndrimin e organizatave mjedisore dhe ricikluesëve në vend mbi ngritjen e impiantit të djegies në jug dhe në lindje të venddepozitimit ekzistues në zonën e Sharrës, Tiranë i është drejtuar me një shkresë MTM, MIE dhe Bashkia Tiranë *së pari*, si përfaqësuesit e institucioneve që kanë përqafuar dhe janë zotuar të zbatojnë programin e transparencës për një qeverisje demokratike e cila i hap rrugën vendimmarrjes me pjesëmarrjen e publikut; *së dyti*, si përfaqësuesit e institucioneve që janë zotuar për zhvillim të qëndrueshëm të vendit duke ruajtur vlerat natyrore në ekuilibër me zhvillimin ekonomik; *së treti*, si përfaqësuesit e institucioneve përgjegjës për të hartuar dhe zbatuar politikën për integrimin dhe ngritjen e Shqipërisë në standardet e Bashkimit Evropian; *mbi të gjitha*, si përfaqësuesit e institucioneve nismëtare dhe firmëtare të ngritjes së impiantit të djegies së mbetjeve urbane në zonën e Sharrës, Tiranë.

Njëzet organizatat mjedisore dhe organizata riciklimi në Shqipëri, kundërshtojmë kontratën e koncesionit *óPër ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike* Zona e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë (ZTMT), dhe kërkojnë anulimin e saj mbështetur në argumentimin si më poshtë:

- Vendimi për djegien e mbetjeve urbane vjen si një diktim nga lart-poshtë, në mungesë transparence dhe në kundërshtim me ligjet kombëtare⁴⁸ dhe evropiane⁴⁹ për menaxhimin e mbetjeve urbane. Theksojmë se projektet siç janë impiantet e djegies, janë investime të cilat kushtojnë financiarisht dhe kanë ndikim afatgjatë në ekuilibrat e fushave të ndryshme të jetës. Ndaj për të shmangur vendime të shpejta që mund të merren nga institucionet, ato duhen mbështetur mbi bazën ligjore dhe strategjinë sektoriale, në mënyrë transparente dhe duke bërë pjesë të vendimmarrjes aktorët e interesit dhe publikun.
- Mungojnë argumentat që mbrojnë domosdoshmërinë e kësaj vendimmarrje të nxituar dhe të papërgjegjshme. Vendimi nuk mbështetet mbi studime të mirëfillta të gjenerimit total të mbetjeve urbane në bashkitë e vendit, apo në raporte monitorimi të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve, të cilat të pasqyrojnë faktorët socio-ekonomikë dhe faktorët territorialë mbi funksionimin dhe mangësitë e këtij shërbimi. Aq më tepër në një kohë kur nevojat për investime publike në sektor janë të mëdha dhe investimet e ngjashme kanë treguar që janë një dështim (*sjellim në vëmendje mos funksionimin me kapacitet të plotë të incineratorit të Elbasanit*).
- Për një investim kaq të rëndësishëm për qytetarët e Tiranës, në kuadër të transparencës, e konform detyrimeve ligjore⁵⁰, duhet të ishin bërë publike, të gjitha fazat e procesit. Nga verifikimet e bëra në faqet zyrtare të institucioneve të përfshira në këtë proces dhe të korrespondencës zyrtare⁵¹, rezulton se këto detyrime janë përmbushur pjesërisht. Në rastin konkret, konsultimi me publikun ka filluar gati dy vjet⁵² pas marrjes së Vendimit nga Këshilli i Ministrave për ndërtimin e impiantit të djegies në Sharrë. Publikimi nuk është kryer si duhet, por edhe kur është kërkuar informacioni përkatës⁵³, institucionet shtetërore

⁴⁸Legjislacioni bazë kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve përbëhet nga 2 ligje kuadër, 10 vendime të këshillit të ministrave dhe 1 urdhër www.qbz.gov.al

⁴⁹ Legjislacioni Evropian për mbetjet <http://ec.europa.eu/environment/waste/legislation/>

⁵⁰ Përveç Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurave Administrative, janë edhe 11 ligje dhe vendime që fuqizojnë të drejtën e publikut për të marrë informacion mjedisor www.qbz.gov.al

⁵¹ Korrespondenca e zvilluar nga Qendra EDEN <https://bit.ly/2CNLYI6> e cila është zhvilluar në kuadër të projektit óTu japim zë qytetarëve - stimulimi i pjesëmarrjes publike mjedisore në Tiranë mbështetur financiarisht nga LëvizAlbania

⁵²Konsultimi me publikun është zhvilluar në datë 28 shtator 2018

<http://drmtirane.akm.gov.al/faces/konsultimpublickun.xhtml>

⁵³ Ibid 4

kanë dhënë me mjaft vështirësi informacion⁵⁴ jo të plotë dhe jo në afatet e parashikuara nga ligji.

- Studimi i fizibilitetit⁵⁵ analizon në mënyrë të njëanshme dhe sipërfaqësore ndikimet dhe përfitimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të këtij investimi. Si i tillë ai ngre më shumë pikëpyetje dhe argumenta kundër ndërtimit të impiantit të djegies së mbetjeve në Sharrë se sa në favor të tij;
- Studimi nuk trajton asnjë alternativë tjetër të trajtimit të mbetjeve urbane. Si i tillë ai nuk mund të arrijë në përfundimin e faktuar dhe të analizuar që ngritja e impiantit të djegies së mbetjeve urbane është qasja më e qendrueshme dhe zgjidhja më e mirë.
- Projekti i impiantit fokusohet tek hallka e fundit e hierarkisë së mbetjeve, duke kapërcyer parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin. Sasia totale e mbetjeve të trajtuara nga impianti në të katërta linjat do të jetë rreth 920 ton/ditë. Kjo sasi e detyron të gjithë Qarkun e Tiranës të ndalojë veprimtarinë ricikluese për të paktën 30 vitet e ardhshme⁵⁶.

Gjetje nga auditimi:

16. Ministria e Mjedisit nuk e ka shqyrtuar dhe konsultuar projektin koncesionar që në fazën e studimeve të fizibilitetit me publikun apo grupet e interesit si organizatat e mjedisit, mendimi profesional dhe i bazuar i së cilëve duhet të ishte përfshirë në vlerësimin real të komponentëve mjedisorë dhe financiarë të këtij projekti.
17. Ministria e Mjedisit nuk ka respektuar detyrimin ligjor mbi transparencën në projektin koncesionar si edhe nuk ka përfshirë publikun apo palët e interesit në vendimmarrje duke shkelur detyrimet e Konventës për të Drejtën e Publikut për Informacion, Pjesëmarrje në Vendim Marrje dhe të Drejtën për t'iu Drejtuar Gjykatës, për Çështje që Lidhen me Mjedisin, ratifikuar në Parlamentin Shqiptar në Qershor 1998.

Konkluzion

10. Pavarësisht ndërhyrjes post factum të organizatave mjedisore dhe organizatave të riciklimit në Shqipëri, mungesa e përfshirjes së tyre si palë interesi të lidhura ngushtësisht me objektin e koncesionit, nuk legjitimon veprimet e Ministrisë së Mjedisit për mos shqyrtimin dhe mos konsultimin e projektit koncesionar që në fazën e studimeve të fizibilitetit në trajtën e konsultimeve me publikun apo grupet e interesit.

Rekomandim

9. MTM në projektet e ardhshme të ndjekë në mënyrë rigoroze fazat e përfshirjes për miratim të ide projekteve me ndikim të madh në jetën e qytetarëve, që kanë të nevojë për mbështetje financiare dhe/ose sjellin rritje të shpenzimeve aktuale për palët, duke përfshirë në konsultim dhe negociim strukturat e ekspertizës së fushës, konsultimin me organizatat vendase dhe të huaja me fushë veprimtari të lidhur me objektin e negociimit.

Në vazhdimësi

Si përfundim Ministria e Mjedisit me shkresën óDërgim Kontrate Koncesionareó nr 6597/1, datë 11.09.2017 drejtuar Bashkisë Tiranë i dërgon kësaj të fundit kopjen e kontratës për ndjekje, vazhdim dhe ekzekutim të kontratës nr.6597, datë 31.08.2017, pa respektuar detyrimet ligjore mbi dakortësinë pa komente të palëve të përfshira në këtë proces si ministritë e linjës dhe organizatat jo qeveritare veprimtaria e së cilave dhe fusha e ekspertizës lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar.

⁵⁴ Rastet janë ankimuar në Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për nxitjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Korrespondenca e plotë <https://bit.ly/2CNLYl6>

⁵⁵ Raporti ólncërimi i mbetjeve si qasje vendoreó <https://bit.ly/2Gc78a8>

⁵⁶ Kontrata koncesionare, pika 4.1 <https://bit.ly/2Gd645O>

4.2 A janë marrë masat e nevojshme për të siguruar eficiencën e projektit?

4.2.1 A është zbatuar procedura e duhur e konkurrimit për këtë investim?

Referuar Ligjit 125/2013 i ndryshuar óPër koncesionet dhe partneritetin publik privató si dhe VKM nr. 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privató i ndryshuar, autoritetet kontraktore kanë detyrimin e përgatitjes së procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit për pjesëmarrësit në garë për dhënien e koncesionit. Parimi bazë është se dhënia e kontratës duhet të bëhet përmes një procesi transparent dhe konkurrues në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat⁵⁷.

Për këtë qëllim, për shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues, në koordinim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik privat⁵⁸. Ky komision, ndër të tjera, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit, shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranura dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar, si dhe formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme⁵⁹. Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit dhe kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik⁶⁰. Komisioni i dhënies së koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej kriterëve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Për sa më lart, grupi i auditimit mori në shqyrtim dokumentacionin e vënë në dispozicion lidhur me procedurën e konkurrimit për dhënien e këtij koncesioni nga ku rezultoi se:

Me Urdhrin nr. 169, datë 05.09.2016 të Ministrit të Mjedisit, është ngritur komisioni për dhënien me koncesion me objekt óNdërtim lanfilli, Incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranëó, i përbërë nga përfaqësueset e AK në funksionin e Kryetares së Komisionit, përfaqësues i AK, përfaqësues të ATRAKO, përfaqësueset e MIE, përfaqësues të Bashkisë Tiranë.

Nga auditimi rezulton se si pjesë e detyrimeve të këtij komisioni, është hartuar studimi i fizibilitetit për këtë projekt, i cili mban datën Dhjetor 2016 dhe nuk është nëshkruar nga dy anëtar të komisionit, përkatësisht përfaqësuesja e MIE dhe një nga përfaqësuesit e BT. Në vijim të procedurës konkurruese, AK ka dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik njoftimin e kontratës, publikuar në Buletinin nr. 16, datë 24.04.2017. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti rezulton se ai nuk përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Dokumentet Standarde të Koncesionit/PPP, apo ato të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit 125/2013, i ndryshuar. Konkretisht, në këtë njoftim nuk identifikohen, vlera e parashikuar e kontratës koncesionare; afati i fundit për dorëzimin e ofertave; adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat; gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat; koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave; kriteret për përjashtimin e ofertuesve; kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënave, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla; lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin; kriteret për dhënien e kontratës; emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës. Njoftimi i kontratës është bërë edhe në gazetën óThe Economistó, vërtetuar kjo nga korrespondenca elektronike mes palëve për kushtet dhe hapësirat e botimit, megjithatë nuk disponohet dokumenti i njoftimit dhe nuk mund të identifikohen elementët që përmban ai. Po kështu, në kundërshtim me nenin 24, të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, as në Dokumentet Standarde të Koncesionit/PPP që AK duhet të përgatisë dhe publikojë, nuk pasqyrohen të plotë elementët e kërkuar, veçanërisht afati për dorëzimin e ofertave dhe afati për hapjen e tyre, referuar përcaktimit se vendi, data dhe koha e hapjes së ofertave duhet të jetë publike dhe duhet të njoftohet nga AK, në mënyrë që cilido operator

⁵⁷ Neni 14 i VKM nr. 575, datë 10.7.2013, i ndryshuar

⁵⁸ Pika 1, Neni 18 i Ligjit 125/2013, i ndryshuar.

⁵⁹ Pika 5, Neni 18 i Ligjit 125/2013, i ndryshuar.

⁶⁰ Neni 22 i Ligjit 125/2013, i ndryshuar.

të jetë prezent me dëshirën e tij. Po kështu, në Dokumentet Standarde të Konkensionit nuk është përcaktuar as zgjidhja e çështjeve të pronësisë mbi territorin ku do të vendoset ky investim, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit 125/2013. Me procesverbalin nr. 9, datë 12.06.2017, Komisioni për dhënien me koncension të projektit shprehet se në prani të përfaqësuesve të kompanisë Ól. E. B.Vó, është bërë mbyllja e pranimi të ofertave nëpërmjet sistemit elektronik të APP, nga ku ka rezultuar vetëm një operator pjesëmarrës. Nga sa u trajtua edhe më lart mbi mangësitë në dokumentet e koncensionit dhe konkretisht vendin, datën dhe orën e hapjes së ofertave, është e paqartë se nga i ka marrë koncensionari të dhënat për tu paraqitur në momentin e duhur. Me procesverbalin e datës 17.08.2017 është vlerësuar dhe përcaktuar si e vlefshme oferta e operatorit të vetëm pjesëmarrës, për të cilin komisioni i sipër përmendur shprehet se përmbush të gjitha kapacitetet dhe kriteret e kërkuara. Për sa më lart, me Vendimin nr. 1, datë 17.08.2017, ky komision i ka propozuar AK shpalljen fitues të operatorit ekonomik I. E. B.V dhe me shkresën nr. 6488, datë 24.08.2017 është dërguar pranë APP formulari i njoftimit të fituesit.

MTM nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm fizik të arkivuar për procedurën e konkurimit dhe as dosjen e dokumenteve të paraqitura nga kompania e shpallur fituese për këtë koncesion, në kundërshtim me nenin 21 të óNormave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RShó. Nga i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion gjendet vetëm formulari i ofertës të këtij operatori dhe asnjë nga dokumentet e parashikuara në DSK si Formulari i Ofertës; Formulari i Sigurimit të Ofertës; Deklarata mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike nga operatori ekonomik; Deklarata për konfliktin e interesit; Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve; Deklarata e disponueshmërisë së makinerive; Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes; Deklaratë e gjendjes gjyqësore; Kriteret e vlerësimit; Vetëdeklarim për ofertuesit e huaj; Specifikimet teknike; Termat e referencës; Formulari për Njoftimin Sókualifikimit; Formulari i Njoftimit të Fituesit; Kushtet e Përgjithshme të Kontratës; Kushtet e Veçanta të Kontratës; Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës; Formulari i Sigurimit të Kontratës; Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor; Formulari i Prokurës.

Krahas sa më lart, procedura konkurruese nuk gjendet as në Sistemin Elektronik të Prokurimit. Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme shkresore dhe komunikimeve elektronike si me MTM, ashtu dhe me APP, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion ky informacion. Konkretisht, është komunikuar elektronikisht me përfaqësues të MTM nëpërmjet mail datë 12.03.2021, ku janë vënë në dijeni këta të fundit për pamundësinë e aksesimit të procedurës në SPE. Me shkresë nr. 1976, datë 18.03.2021, MTM ka kërkuar nga APP zgjidhjen e problemit në sistem për shfaqjen e dosjes elektronike. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 2070/1, datë 29.03.2021, APP ka sqaruar se dosja elektronike për këtë procedurë nuk aksesohet në sistem pasi në momentin e kryerjes së veprimeve në sistem, KVO nuk ka vijuar me përfundimin e procesit duke mos kërkuar arkivimin e dosjes elektronike. Për shkak të mos arkivimit, kjo procedurë nuk mund të aksesohet nga llogaria óaudituesó në SPE. Në shkresën e sipër cituar, APP sqaron se procesi i arkivimit mund të bëhet nga llogaria e administratorit të sistemit në MTM, duke ndryshuar fjalëkalimin e llogarisë së KVO. MTM i është drejtuar përsëri në formë shkresore APP, me shkresën nr. 1976, datë 07.04.2021 për arkivimin e dosjes elektronike dhe me mail të datës 19.05.2021 nga APP deklarohet se është bërë procesi i arkivimit të procedurës elektronike dhe se nga ky moment kjo dosje është e aksesueshme në sistem. Në përgjigje të këtij e-mail, grupi i auditimit ka provuar përsëri të aksesojë dosjen në sistem dhe përsëri dosja nuk shfaqet. Në mungesë të procedurës elektronike dhe në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 154/2014 óPër organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitó dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 3000-3200), grupi i auditimit ka mbajtur Akt Konstatimin nr. 2, datë 21.05.2021, protokolluar në MTM me nr. 2874/1, datë 21.05.2021. Për sa më lart procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncension, nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimeve ligjore të sipër cituara, veprime dhe mos veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e Komisionit për Dhënien me Konkension me objekt “Ndërtim lanfilli, Incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë”.

Gjetje nga auditimi:

18. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion rezultoi se Studimi i Fizibilitetit nuk përmban nënshkrimin e të gjithë anëtarëve të komisionit dhe konkretisht mungon nënshkrimi i këtij dokumenti nga përfaqësuesja e MIE dhe nga një prej përfaqësuesve të BT;
19. Në Njoftimin e Kontratës nuk identifikohen, vlera e parashikuar e kontratës koncesionare; afati i fundit për dorëzimin e ofertave; adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat; gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat; koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave; kriteret për përjashtimin e ofertuesve; kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla; lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin; kriteret për dhënien e kontratës; emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës;
20. Dokumenti i njoftimit të kontratës në gazetën *“The Economist”* nuk disponohet nga MTM dhe nuk mund të identifikohen elementët që përmban ai;
21. Në DSK nuk pasqyrohen të plota elementët e kërkuar, veçanërisht afati për dorëzimin e ofertave dhe afati për hapjen e tyre, referuar përcaktimit se vendi, data dhe koha e hapjes së ofertave duhet të jetë publike dhe duhet të njoftohet nga AK, në mënyrë që cilido operator të jetë prezent me dëshirën e tij dhe nuk është përcaktuar as zgjidhja e çështjeve të pronësisë mbi territorin ku do të vendoset ky investim;
22. Procedura konkurruese nuk gjendet as në Sistemin Elektronik të Prokurimit, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme shkresore dhe komunikimeve elektronike me MTM dhe APP.

Konkluzion:

11. Procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncension, nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimet ligjore.

Rekomandim:

10. AK të marrë masa të menjëhershme të dokumentojë dhe ruajë në përputhje me parashikimet ligjore të gjithë procedurën e konkurrimit, si fizike ashtu edhe elektronike. Për këtë, KVO përkatëse, në momentin e largimit të bëjnë mbylljen dhe arkivimin e procedurave në SPE për të cilat janë përgjegjës, si dhe të bëjnë dorëzimet e nevojshme pranë grupeve të punës për këtë qëllim.

Pas marrjes së këtij Raporti Përfundimtar Auditimi

11. AK të marrë masa që në bashkëpunim me APP të shqyrtojnë mundësinë e modifikimeve në sistemin elektronik të prokurimit sa i takon aksesit në rastet kur procedurat nuk janë arkivuar nga KVO dhe kjo e fundit nuk është më pjesë e AK.

Menjëherë dhe në vijim

4.2.2 A janë përmbushur detyrimet e kontratës koncesionare deri në momentin e auditimit?

Kontrata e lidhur mes palëve (Ministria e Mjedisit dhe I. E. B.V) më datë 31.08.2017, ka për objekt financimin, projektimin, rehabilitimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e veprave dhe veprave plotësuese për mbetjet e Qarkut Tiranë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga ana e koncensionarit, si dhe transferimin e tij në përfundim të periudhës 30 vjeçare të koncensionit, në pronësi të Bashkisë Tiranë. Referuar përcaktimeve të kontratës, koncensionari angazhohet të ndërtojë/rehabilitojë veprat e mëposhtme, detajuar sipas zërave dhe afateve në Aneksin IV bashkëlidhur kontratës:

- Loti A në kapsulimi i venddepozitimit ekzistues;
- Loti E në Impianti i përpunimit të ujrave të ndotura;
- Loti D në Impianti i diferencimit të mbetjeve;
- Loti B në Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane;

Loti C në Impianti i përpunimit të mbetjeve;

Loti I në Nënstacioni elektrik;

Loti F në Venddepozitimi i hireve;

Loti G dhe H në Venddepozitimi i mbetjeve inerte.

Referuar pikës 6.8 të kontratës, afati i fillimit të punimeve është 30 ditë nga plotësimi i të gjitha kushteve bashkarisht: përfundimi i procesit të shpronësimit dhe marrja në dorëzim e shesheve, pajisja e koncensionarit me leje zhvillimore dhe marrja e të gjitha lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për fillimin e ndërtimit të veprave, ndërkohë afati i përfundimit të ndërtimeve, siç parashikohet në aneksin e sipër përmendur është brenda 6 vitesh.

Referuar pikës 5.4.3 të kontratës, me qëllim përmbushjen me eficiencë dhe efektivitet të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të ndihmojë, asistojë dhe mbështesë Koncensionarin duke garantuar brenda afateve çdo autorizim, leje zhvillimore, leje ndërtimi, dorëzim sheshesh, apo eliminimin e çdo pengese tjetër brenda kufijve ligjorë. Konkretisht, AK ka detyrimin të sigurojë përfundimin e plotë dhe pa asnjë defekt të procesit të shpronësimeve të nevojshme brenda një periudhe 6 mujore nga data efektive e kësaj kontrate dhe zbardhjen e lejes zhvillimore për të gjithë projektin, brenda një periudhe 8 mujore nga data efektive e kësaj kontrate.

Për sa më lart, nga auditimi rezultoi se, me shkresën nr. 133, datë 06.05.2020, koncensionari i drejtohet AK me një sërë problematikash, të cilat si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve të AK, kanë sjellë vonesa në zbatimin e kontratës si vijon:

- Dorëzimi i venddepozitimit të mbetjeve nga Bashkia Tiranë, është kryer me procesverbalin nr. 44121, datë 07.12.2017, pra rreth 3 muaj me vonesë;
- Dorëzimi i shesheve apo parcelave të tjera plotësuese ende nuk është bërë (deri në momentin e dërgimit të shkresës së sipër përmendur);
- Referuar VKM nr. 811, datë 26.12.2018, rezulton se nuk janë shpronësuar të gjitha pronat e dorëzuara me kërkesën nr. 60, datë 22.02.2018. Për këtë qëllim është kërkuar miratimi i një shtese VKM-je, proces i cili ka vijuar vonesat, duke u finalizuar me VKM nr. 1154, datë 24.12.2020.
- Mos përfundimi plotësisht i procesit të shpronësimit ka sjellë edhe vonesa në zbardhjen e lejes së ndërtimit, e cila është lëshuar me Vendimin nr 14, datë 17.05.2019 dhe ndryshuar me Vendimin nr. 52, datë 28.12.2020 të KKT.
- Mos miratimi i VNM për mbetjet e rrezikshme (kusht tjetër për zbardhjen e lejes së ndërtimit).

Për sa më lart, rezulton se si pasojë e zbardhjes së lejes së ndërtimit në mes të vitit 2019 janë shkaktuar vonesa në zbatimin e kontratës prej pothuaj 2 vitesh (që nga vitit 2017 i nënshkrimit të kontratës). Sa i takon miratimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mbetjet e rrezikshme jo radioaktive, nga korrespondenca e NjZP me AK, konstatohet se ky zë nuk është pjesë e kontratës së nënshkruar mes palëve, ndërkohë që në situacionet e supervizorit identifikohet edhe kryerja e këtyre punimeve, në një kohë që koncensionari nuk e ka të parashikuar trajtimin e këtyre lloj mbetjeve. Referuar përcaktimeve të sipër përmendura të kontratës, AK nuk ka detyrimin e nxjerrjes së lejeve në fjalë, megjithatë ka detyrimin të ndihmojë dhe mbështesë Koncensionarin në nxjerrjen e tyre. Për sa më lart, në dosjet e vëna në dispozicion, nuk u konstatua asnjë dokumentim për nxitje apo kërkesë llogarie nga AK ndaj enteve publike përgjegjëse për lejet dhe autorizimet e nevojshme për fillimin e punimeve. Krahas mos angazhimit të AK në përsheptimin dhe mbështetjen e procesit të dhënies së lejeve përkatëse, konstatohet gjithashtu se ky proces ka pësuar vonesa edhe për shkak të mos plotësimit të dokumentacionit të depozituar nga Koncensionari për çështjen e shpronësimeve, referuar shkresës nr. 6390/5, datë 30.12.2019 të sektorit të shpronësimeve pranë MIE.

Në kontratën e lidhur mes palëve, pika 6.1, përcaktohet se për monitorimin e zbatimit dhe përmbushjes së detyrimeve të kontratës, brenda një muaji nga data efektive e kontratës 31.08.2017, krijohet Njësia e Zbatimit të Projektit (NjZP) me përbërje:

- Dy anëtar nga AK (MM);

- Një anëtar nga Ministria përgjegjëse për energjinë (sot MIE);
- Dy anëtar nga Bashkia Tiranë.

Për sa më lart, me urdhrin nr. 366 datë 21.12.2017, i ndryshuar, është ngritur NjZP, e cila i raporton AK çdo 3 muaj ndër të tjera mbi ecurinë e punimeve dhe masat e marra për eliminimin e vonesave, zbatimin e kontrollit të cilësisë dhe të sistemeve të sigurimit, ngjarje apo rrethana për të cilat AK mund të jetë përgjegjës, etj. Referuar pikës 6.1 të kontratës, kjo njësi është ngritur me 3 muaj vonesë.

Gjatë periudhës së auditimit u konstatua se NjZP nuk ka funksionuar e plotë për shkak të largimit të një anëtarit të MM dhe prej kohësh ky institucion nuk ka marrë masa për zëvendësimi i tij, panvarësisht kërkesave të vazhdueshme nga NjZP.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga NjZP, rezulton se që nga fillimi i punimeve datë 20.05.2019 dhe deri në fund të periudhës nën auditim, janë realizuar punimet si vijon:

- Loti A Kapsulimi i venddepozitimit ekzistues. Puna vijon sipas grafikut të punimeve i cili parashikon që ky LOT të përfundojë në muajin nëntor 2021. Aktualisht janë realizuar rreth 74% e punimeve. Referuar periudhës së fillimit të punimeve cituar më lart dhe Aneksit IV të Kontratës óGrafiku i punimeveô, ky Lot duhej të përfundonte brenda vitit të parë të punës pra brenda vitit 2020;
- Loti B Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane. Janë realizuar 100% e punimeve në bazë të grafikut. Ky Lot ka përfunduar sipas afateve të grafikut të punimeve.
- Loti C Impianti i përpunimit të mbetjeve. Ecuria e punës ka vijuar sipas grafikut të punimeve. Ka nisur realizimi i zërit të parë të punimeve "punime civile". Ky zë i cili është edhe zëri kryesor shtrihet në një periudhe kohore në vite.
- Loti D Impianti i diferencimit të mbetjeve. Janë kryer rreth 60% e punimeve civile dhe aktualisht pritët montimi i linjës së diferencimit e cila është prodhuar dhe pritët të vije në Shqipëri në javët në vijim. Edhe për këtë Lot, referuar Aneksit IV të kontratës Grafiku i punimeveô, punimet duhet të kishin përfunduar brenda vitit të parë, pra brenda vitit 2020;
- Loti E Impianti i përpunimit të ujërave të ndotur. Përsa i përket këtij loti, kanë përfunduar të gjitha punimet civile dhe aktualisht po realizohet faza e dytë e cila ka të bëjë me instalimin e Linjës Teknologjike. Janë realizuar rreth 50% e punimeve. Edhe për këtë Lot, referuar Aneksit IV të kontratës óGrafiku i punimeveô, punimet duhet të kishin përfunduar brenda vitit të parë, pra brenda vitit 2020;
- Loti F Venddepozitimi i hireve. Sipas grafikut të punimeve, ky lot duhet të fillonte punimet në mes të vitit të parë të fillimit të punimeve (në këtë rast rreth muajit janar 2020) dhe duhej të përfundonte brenda 12 muajve (rreth muajit janar 2021). Ndërkohë nga të dhënat e NjZP rezulton se për këtë Lot punimet kanë filluar me vonesë në Qershor 2021 dhe konkretisht punimet e para që kanë të bëjnë me gërmimet, për të cilat janë realizuar rreth 15% të punimeve.
- Loti G + H Dy landfillet e depozitimit të mbetjeve inerte. Sipas grafikut të punimeve këto dy Lote duhet të nisin në mesin e vitit të dytë të fillimit të punimeve (pra rreth fundit të vitit 2020) dhe të përfundojnë brenda një periudhë 1 vjeçare (rreth fundit të vitit 2021). Referuar të dhënave të NjZP, deklarohet se punimet për këtë Lot nisin në muajin Qershor 2022, por nga ana e koncesionarit janë marrë masa për realizimin e ketyre Loteve më parë, pasi shihet e arsyeshme të vendosen në operim përpara afatit të përcaktuar në grafikun e punimeve. Janë realizuar rreth 15% e punimeve.
- Loti I Nënstacioni elektrik. Ky Lot, sipas grafikut të punimeve duhet të fillojë dhe përfundojë punimet brenda vitit të dytë të fillimit të punimeve (rreth 3 muajit të dytë të vitit 2021). Referuar të dhënave të NjZP, deklarohet se punimet për këtë Lot janë parashikuar të fillojë në muajin Janar 2022. Shoqëria ka drejtuar një kërkesë zyrtare Supervisorit të punimeve në lidhje me rishikimin e grafikut të punimeve.

Po kështu, është vijuar me disa zëra punimesh plotësuese si: Ndërtim rrugë aksesit rreth 50% të punimeve; Ndërtim sheshe operimi rreth 70% e punimeve; Rrethim objekti realizuar 100% e punimeve; Sistemime dhe gjelbërime rreth 80% e punimeve. Të gjitha këto punime duhet të kishin përfunduar brenda 1.5 viteve të para të fillimit të punimeve, pra brenda vitit 2020.

Krahas procesit monitorues që kryen NjZP për fazën e ndërtimit, në kontratë nuk parashikohet asnjë klauzolë se si do të kryhet procesi i monitorimit në vijim të marrëdhënieve kontraktuale, pas përfundimit të punimeve. Aktualisht shpenzimet e kryera për këtë shërbim, monitorohen nga MIE për shkak të detyrimit kontraktual që ka kjo e fundit, për të mbështetur financiarisht BT gjatë 4 viteve të para të operimit. Në përfundim të periudhës 4-vjeçare nuk është parashikuar asnjë strukturë e cila të monitorjë saktësinë dhe vërtetësinë e shpenzimeve që do të kryhen nga BT, në funksion të sasive të mbetjeve që do të depozitohen në landfill.

Ndërkohë, me nënshkrimin e kësaj kontrate, Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Tiranë, kanë detyrimin të nënshkruajnë Aneksin IX óForma e angazhimit mbi detyrimet e NjQVô, aneks i cili është nënshkruar pas një periudhe 7 mujore nga Bashkia Tiranë, ndërkohë nuk është nënshkruar nga Bashkitë e tjera pjesë e qarkut.

Për shërbimin e ofruar, NjQV-t e Qarkut Tiranë kanë detyrimin të paguajnë tarifën prej 29 euro/ton të depozituar pranë koncensionarit. Nga auditimi rezultoi se, pavarësisht se kjo kontratë detyron të gjithë NjQV-t e Qarkut Tiranë të depozitojnë mbetjet e tyre pranë koncensionarit, detyrimi për të shlyer diferencën në rastet e mos depozitimit të sasisë minimale të garantuar të mbetjeve, bie vetëm mbi Bashkinë Tiranë, përcaktuar në pikën 7.3.2 të kontratës.

Sasitë vjetore të mbetjeve të depozituara dhe vlerat e paguara

në lekë

	2018	2019	2020
Mbetje (ton/vit)	228.760,80	239.518,67	254.604,66
Pagesa nga të ardhurat e Bashkisë	224,000,000	447,124,798	480,000,000
Transferta nga MIE	753,000,000	500,000,000	800,000,000

Nga tabela vihet re se, sa i takon sasisë minimale të nevojshme për tu depozituar prej 550 ton/ditë (200,750 ton/vit), Bashkia Tiranë ka arritur të përmbushë kushtet e kontratës, pa kosto shtesë. Megjithatë nga korrespondenca e vazhdueshme me MIE dhe MFE, vihet re se që në vitin e parë të operimit, Bashkia Tiranë ka vështirësi financiare për përballimin e shërbimit. Nga të dhënat e tabelës vihet re se Bashkia Tiranë arrin të mbulojë nga buxheti i saj vetëm 23% të shërbimit për vitin 2018, 47% për vitin 2019 dhe 38% për vitin 2020. Sa i takon pagesave të kryera nga Bashkia Tiranë, për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve, vihet re se si pasojë e mos përfundimit të ndërtimit të impjantit të trajtimit të mbetjeve, Koncensionari ende sot nuk ka trajtuar dhe asgjesuar asnjë sasi mbetjesh të marra në dorëzim edhe pse pagesën për shërbimin e ka përfituar të plotë. Pra, Bashkia Tiranë prej 2 vitesh po parapaguan shërbimin e trajtimit të mbetjeve, i cili ende nuk kryhet.

Mbi tarifën e depozitimit të mbetjeve urbane në landfill

Në këtë paragraf grupi i auditimit ofron një panoramë të shpërndarjes financiare që zë shërbimi i pastrimit të qytetit dhe depozitimi i mbetjeve urbane në landfillin e Sharrës për Bashkinë Tiranë. Kjo bashki aktualisht ka në përdorim 5 kontrata me operator ekonomik si në tabelën 6. të nënshkruara për një afat 3 vjeçar dhe 25 vjeçar kontrata e E. Tirana. Në tabelën më poshtë vlera prej **1,288,727,885.74 lekë**, i referohet shpenzimeve buxhetore të kësaj bashkie të konvertuara për 1 (një) vit kalendarik për periudhën e auditimit 2017-2020.

Tabela 6 - Kontratat e pastrimit të mbetjeve urbane për Bashkinë Tiranë

Nr.	Kontraktuesi	Vlera e kontratës në lekë	Vlera e kontratës në lekë/vit
1	A. I. G.	568,519,169.00	189,506,390.00
2	F. shpk	838,800,920.52	279,600,306.84
3	K. shpk dhe B.-C. srl	612,427,235.70	204,142,411.90
4	A.-G. shpk	608,036,332.00	202,678,777.00
5	E. Tirana	-	412,800,000.00
	TOTALI	2,627,783,657.22	1,288,727,885.74

Burimi: Bashkia Tiranë - Punoi Grupi i auditimit KLSH

Bashkia Tiranë e ndodhur në kushtet e ôklientitô për kompaninë koncesionare ôl. E. BV shpkô, për periudhën objekt auditimi ka ofruar evidenca mbështetëse, lidhur me koston financiare të depozitimit të mbetjeve në landfill për efekt të firmës koncesionare. Kjo kosto në kontratën midis palëve është përcaktuar duke vlerësuar çdo ton mbetje ditore me **29 euro/ton**, ku për të cilën nuk është negociuar apo analizuar nga pala e AK me koncesionarin në terma të barrës financiare për taksapaguesit. Në lidhje me këtë kosto (depozitimi në landfill) e vlerësuar për zërin e operimit dhe mirëmbajtjes së impjantit, grupi i auditimit për të ofruar panoramë krahasuese edhe me shpenzimet e viteve 2015-2017 ku depozitimet në landfill kryheshin nga operatorët ekonomik të pastrimit të qytetit, po e paraqesim në formë tabelare si më poshtë:

Tabela 7 - Shpenzimet e BT për pastrimin dhe depozitimin e mbetjeve urbane në landfill
(në mijë lekë)


	Emërtimi	Plan	Fakt	Total
Viti 2015	Pastrimi i qytetit	1,144,486	1,144,275	1,144,275
	Depozitimi në landfill	0	0	
Viti 2016	Pastrimi i qytetit	1,685,000	1,257,654	1,257,654
	Depozitimi në landfill	0	0	
Viti 2017	Pastrimi i qytetit	1,355,799	1,078,915	1,078,915
	Depozitimi në landfill	0	0	
Viti 2018	Pastrimi i qytetit		1,288,727	2,265,727
	Depozitimi në landfill		977,000	
Viti 2019	Pastrimi i qytetit		1,288,727	2,265,852
	Depozitimi në landfill		977,124	
Viti 2020	Pastrimi i qytetit		1,288,727	2,568,727
	Depozitimi në landfill		1,280,000	
	Totali i Depozitimit në landfill			3,234,124
	Totali i Pastrimit të qytetit			4,945,099

Burimi: Bashkia Tiranë - Punoi Grupi i auditimit KLSH

Vihet re qartësisht se, shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë në momentin e nënshkrimit të kontratës koncesionare për ôNdërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ôl. E. B.V shpkô, janë dyfishuar jo vetëm krahasur me periudhën 2015-2017, por kanë rënduar buxhetin e shtetit (për aq kohë sa rimburohet ende nga MIE) me 2-fishin e vlerës për vitet 2018-2020. Kjo ka ardhur si shkak i tarifës

koncesionare të depozitimit të mbetjeve urbane prej 29 Euro/ ton mbetje urbane, për të cilën subjektet e përfshira në auditim nuk kanë vendosur në dispozicion asnjë evidencë për negociimin paraprak të saj me operatorin ekonomik koncesionar.

Kontratat e OE për pastrimin e qytetit në vitet 2015-2017 janë kontraktuar për këtë shërbim si edhe për depozitimin në landfill me një vlerë mesatare vjetore prej 1,160,282,032 lekë, ndërkohë që për vitet 2018-2020 ndërsa është rritur kosto mesatare vjetore e pastrimit në 1,288,727,885 lekë kësaj vlere i shtohet edhe kosto e tarifës koncesionare prej 3,234,124,798 lekë, duke shkruar në shpenzime mesatare për 2018-2020 në 2,366,769,485 lekë. Nëse do të shpreheshim për një vit kalendarik, nga të dhënat e tabelës 7 vihet re qartësisht se për vitin 2020 nga shpenzimet buxhetore prej 1,288,727,886 lekë nëse do të operohej si më herët vetëm me kontratat e pastrimit, aktualisht duke përfshirë tarifën e koncesionit, buxheti rëndohet dhe shkon në 2,568,727,886 lekë. Vlerë kjo e cila rëndon edhe me tëpër për taksapaguesit, konkretisht 2-fishi i shumës financiare, të cilët janë duke paguar sot për shërbimin e incenerimit të mbetjeve urbane, ndërkohë që vetë procesi i incinerimit do të zhvillohet në një periudhë më vonë, sepse Incineratori si objekt industrial ende nuk është ndërtuar.



Burimi: Bashkia Tiranë - Punoi Grupi i auditimit KLSH

Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Tiranë është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/23, datë 25.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó nga z. E. V. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Kontratat e shërbimit aktualisht përfshijnë detyrime që kanë të bëjnë me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në landfill; pra po të shtohen këtyre kostove edhe ato të menaxhimit të landfillit nga BT deri në kohën kur ky institucion kishte detyrimin ta menaxhonte atë (pa përfshirë këtu realisht performancën dhe problematikën që ka shoqëruar objektin në kohë), me siguri kostot reale do të jenë më të ulta.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga BT, sqarojmë se grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve deri në landfill është shërbim që kryhet nga operatorët ekonomikë që realizojnë pastrimin e qytetit, ndërkohë argumenti më sipër i grupit të auditimit i referohet 2-fishimit të vlerës financiare për pastrimin dhe djegien e mbetjeve, duke patur në fokus taksapaguesin.

Së fundmi, konstatohet se edhe vetë koncensionari ka vështirësi financiare në përmbushjen e detyrimeve të kontratës. Konkretisht, në planin e biznesit të paraqitur nga ky i fundit për miratimin e projektit, në pikën 5 të tij óMënyra e financimit (burimet e financimit)ó përcaktohet se kosto e projektit do të përballohet në vlerë të plotë nga kapitali i shoqërisë dhe nga burimet e brendshme të saj, pa patur nevojë që të merret një kredi bankare. Ndërkohë nga auditimi rezultoi se me shkresën

nr. 304, datë 14.10.2020, koncensionari I. E., i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke e vënë në dijeni se është financuar me dy kontrata Kredie Afatgjatë dhe Afatmesme për vijimin e projektit. Nga shkresa e sipër përmendur, vihet re se për këtë financim koncensionari bazohet në nenin 9.1 të kontratës koncensionare e cila përcakton óAK ka detyrimin të mbajë të pa dëmtuar Koncensionarin për çdo humbje direkte ose fitim të munguar të pa paguar.....ô, dhe e lidh këtë ódëmtimô me vonesat që i ka shkaktuar AK në vënien në dispozicion të shesheve, lejeve të ndërtimit, etj. Megjithatë referuar planit të biznesit të sipër cituar, pika 5 e tij siç u përmend edhe më lart përcakton se financimi është plotësisht nga kapitali i shoqërisë, pra që ajo tashmë e zotëron vlerën e plotë të investimit dhe nuk saktësohet apo specifikohet në asnjë rast se kjo vlerë do të mbulohet nga të ardhura që koncensionari do të gjenerojë gjatë operimit, apo ndonjë parashikim tjetër për raste të mundshme kur mund të lindë nevoja për financim. Pra, sipas planit të biznesit është përcaktuar në mënyrë eksplicite se koncensionari nuk ka nevojë për financime shtesë. Për më tepër, në shkresën e sipër cituar, përcaktohet se këto kredi do të garantohen duke vënë në garanci të ardhurat që do të gjenerohen nga kontrata koncensionare në fjalë, duke përbërë një risk të mundshëm për vijimin e projektit në rast se për çfarëdo shkakku koncensionari nuk do të arrijë të gjenerojë sasinë e nevojshme të të ardhurave të vëna në garanci për kredinë.

Në lidhje me këtë rekomandim nga MIE është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/22, datë 21.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitô nga znj. V. H. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Lidhur me rekomandimin për marrjen e masave nga AK për nxitjen e koncensionarit për avancimin e punimeve që janë jashtë afatit të parashikuar, për menaxhimin e kontratës koncensionare funksionojnë Njësia e zbatimit të projektit dhe Supervizori i punimeve. Deri më sot janë ndeshur problematika në konstituimin e NjZP, pasi anëtari përfaqësues i MIE nuk ka profil inxhinier ndërtimi, ndërsa prej kohësh MTM nuk ka paraqitur përfaqësuesin e saj për këtë njësi. Megjithatë për nxitjen e avancimit të punimeve është bërë riazhornimi i gafikut të punimeve për rikuperimin e vonesave gjatë periudhës së pandemisë.
2. Lidhur me rekomandimin ku AK të kërkojë nga Koncensionari një analizë të detajuar mbi vlerat e kredisë së përfutur dhe mënyrën e përdorimit dhe mbulimit të tyre, si dhe një analizë mbi nivelin e të ardhurave të parashikuara në vitet në vijim, për të marrë një farë garancie se mbulimi i kredisë nuk do të çënojë vijimin e kontratës, pika 16.3 e kontratës koncensionare parashikon se ókoncensionari mund të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo palë financuese/huadhënëse.....me kusht që financimi të shërbejë përmbushjes së detyrimeveô. Për sa më sipër koncensionari ka bërë të gjithë njoftimet përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Lidhur me rekomandimin për AK për marrjen e masave për nxitjen e avancimit të punimeve, sqarojmë se referuar pikës 6.1 të kontratës, NjZP nuk është përgjegjëse për menaxhimin e kontratës, por për monitorimin e zbatimit të punimeve. Ndërkohë MIE në rolin e AK aktual dhe mbi NjZP në kompetenca, nuk mund të qëndrojë pasive përballë mos përmbushjeve në afat të detyrimeve. Kjo edhe për faktin se në përfundim të çdo periudhe monitoruese, NjZP i raporton pikërisht MIE-s. Megjithatë, për sa më lart grupi i auditimit do të riformulojë rekomandimin duke përfshirë edhe NjZP në rekomandim. Sa i takon mangësive në përbërjen e NjZP, kjo çështje është trajtuar dhe shoqëruar me një rekomandim më vete.
2. Lidhur me komentin në pikën 2 më lart, së pari ju sjellim në vëmendje se gjatë procesit miratues të dhënies së koncensionit, në pikën 5 të planit të biznesit të dakordësuar mes palëve, koncensionari është shprehur se financimi është plotësisht nga kapitali i shoqërisë, pra që ajo tashmë e zotëron vlerën e plotë të investimit dhe nuk saktësohet apo specifikohet në asnjë rast se kjo vlerë do të mbulohet nga të ardhura që koncensionari do të gjenerojë gjatë operimit, apo ndonjë parashikim tjetër për raste të mundshme kur mund të lindë nevoja për financim. Pra, sipas planit të biznesit është përcaktuar në mënyrë eksplicite se koncensionari nuk ka nevojë për financime shtesë. Në këtë pikë, në momentin kur koncensionari ka devijuar nga parashikimet

dhe përcaktimet e planit të biznesit, pra financimi nuk është më plotësisht nga kapitali i shoqërisë, si dhe ka kërkuar financime nga të tretë, lind risku i mos përmbushjes së detyrimeve për shkaqe financiare. Për këtë arsye, AK në cilësinë e mbrojtjes së interesave publike duhet të rrisë kërkesën e llogarisë nëpërmjet vënies në dispozicion të një analize nga ana e koncensionarit, se si do të garantohet përmbushja e tyre pas këtij devijimi nga plani i biznesit dhe ndodhur para faktit të një vështirësie financiare të koncensionarit. Së dyti, pika 16.3 e kontratës koncensionare (të cilën në observacion e citoni të cunguar), parashikon se “Koncensionari, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate, ka të drejtë të vendosë hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet e veprave që do krijohen në zbatim të projektit dhe punimeve, si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me kusht që hipoteka, peng, apo barra tjetër dhe marrëveshja përkatëse e financimit ti shërbejë përmbushjes së detyrimeve të koncensionarit”. Me shkresën nr. 304, datë 14.10.2020, koncensionari I. E. B.V, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke e vënë në dijeni se është financuar me dy kontrata Kredie Afatgjatë dhe Afatmesme për vijimin e projektit. Në këtë shkresë përcaktohet se këto kredi do të garantohen duke vënë në garanci të ardhurat që do të gjenerohen nga kontrata koncensionare në fjalë. Në shkresën e mësipërme nuk ka asnjë informacion tjetër se cilat asete apo vepra ka vënë në hipotekë, peng, apo barrë tjetër koncensionari. Theksojmë në këtë pikë se aseti kryesor i këtij projekti, impianti i djegies, ende nuk ekziston. Ndodhur para faktit se,

-për kontratat e kredisë nuk ka informacion;

-impjanti i djegies nuk ekziston ende dhe rrjedhimisht nuk gjenerohen të ardhura nga prodhimi dhe shitja e energjisë;

-i vetmi burim të ardhurash për momentin janë pagesat e “klientëve” që depozitojnë mbetje dhe një pjesë e tyre do të përdoren për shlyerjen e dy kontratave të kredive,mbetet e pa qartë dhe e pa sigurt se me çfarë kapitali do të vijojë finalizimi i të gjithë veprave të projektit dhe kostot operative të vijimësisë. Në këtë kuptim, AK dhe NJZP, në cilësinë e palëve që garantojnë interesat e qeverisë Shqiptare, duhet patjetër të kërkojnë llogari nga koncensionari për riskun e finalizimit të projektit nëpërmjet kërkesës së analizave të përmendura në rekomandim.

Së fundmi, është e paqartë se çfarë kundërshtoni nëpërmjet observacionit, pasi grupi i auditimit nuk ka rekomanduar që AK të kërkojë anulimin e kredisë së marrë nga koncensionari, por në kushtet e risqeve mbi situatën financiare dhe mos pasjes së asnjë informacioni të detajuar mbi kredinë e marrë, përgatitja e një analize mbi vijueshmërinë e projektit është çështje performance (zbatimi projekti) dhe aspak në kundërshtim me ndonjë përcaktim në kontratë.

Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Tiranë është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/23, datë 25.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitô nga z. E. V. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimin "Në përfundim të fazës ndërtimore 4 vjeçare nga BT nuk është ngritur asnjë strukturë që do të monitorojë dhe ndjekë vërtetësinë e shpenzimeve që do të kryhen nga BT, në funksion të sasive të mbetjeve që do të depozitohen", ju bëjmë me dije se kontrata koncesionare parashikon si detyrim ngritjen e NJZP e cila sipas nenit 1.1 të saj parashikon: "NJZP është njësi e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor për monitorimin e realizmit të kontratës të përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët dy përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, një përfaqësues i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe dy përfaqësues të Bashkisë Tiranë". NJZP monitoron përmbushjen nga koncesionari të detyrimeve të tij në lidhje me përmbushjen e objektit të kontratës dhe konform detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratv. Në dispozitat e kontrates percaktohen qartë rolet e çdo Autoriteti Përgjegjës duke filluar që me Autoritetin Kontraktor, për të vazhduar edhe me rolet e NJVQT, të cilat janë përgjegjëse për mbledhjen dhe/ose transportimin e mbetjeve urbane në Qarkun Tiranë. Sjellim në vëmendje që kryeja e pagesave është bërë në përputhje me angazhimet kontraktore të marra nga Autoriteti Kontraktues në kontratën e koncesionit, hartimi i të cilës bazohet mbi studimin e fizibilitetit që është baza e projektit PPP dhe modelin financiar. Për sa

kohë që kemi të bëjmë me një marrëdhënie kontraktuale sipas të cilës janë marrë përsipër të drejta dhe detyrime, rrjedhimisht edhe angazhimet financiare janë parashikuar të shlyhen sipas saj ("LOB "Angazhim buxhetor" është marrja përsipër e detyrimeve financiare, në formë të shkruar, përmes hyrjes në marrëdhënie kontraktuale.) Sqarojmë se kontrata e incineratorit të Tiranës është një projekt ku parashikimet kontraktore për pagesat janë të lidhura drejtpërdrejtë me depozitimin e mbetjeve në landfill; forma e PPP është "Pay for Use", pra modeli i kontratës së PPP për këtë kontratë është "Paguaj për shërbimin". Për sa kohë që përdoruesit kanë depozituar mbetje në landfill, kjo do të shoqërohet edhe me kryerjen e pagesës përkatëse për shërbimin, pagesë që nuk është e lidhur me grafikun e punimeve dhe fazat e ndërtimit. Bashkia Tiranë sipas rolit të përcaktuar në kontratë "Klienti", sipas kontratës ka detyrim kontraktual të garantojë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës depozitimin e sasisë minimale të mbetjeve urbane. Përmeshja e detyrimeve kontraktuale, monitorimi dhe ceuria e projektit janë detyrime të përcaktuara qartazi për Autoritetin Kontraktor, në përputhje kjo me parshikimet e dispozitave të Ligjit 125/2013 "Për koncesionet /ppp".

1. Lidhur me konstatimin óDorëzimi i vend depozitimit nga BT është bërë me vonese sipas proces verbalit nr. 44121 datë 07.12.2017, sqarojmë se vonesa ka ardhur si pasojë e përgatitjes së materialit të nevojshëm, i cili ka kërkuar kohë në përgatitjen e tij nga grupi i punës i ngarkuar për këtë qëllim. Njëkohësisht kjo shmangie në kohë, nuk ka ndikuar në ecurinë e detyrimeve të parashikuara në kontratën bazë koncesionare.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Lidhur me pretendimet në pikën 1, mbi funksionin e NjZP, sqarojmë se së pari, detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj njësie përcaktohen në nenin 6.1: "NjZP monitoron përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij në lidhje me objektin e kësaj kontrate.....". Pra referuar këtij neni, NjZP monitoron vetëm detyrimet që ka Koncesionari dhe jo pagesat që i bëhen koncesionarit. Në këtë kuptim ky proces, siç trajtohet edhe në material, mbetet i pa mbuluar. Së dyti, lidhur me konceptin "Paguaj për shërbimin", sqarojmë se shërbimi për të cilin është lidhur kjo kontratë koncesionare përfshin një varg procesesh që nga dorëzimi i mbetjeve nga ana e Bashkisë, e duke vazhduar me trajtimin dhe djegien. Për sa kohë asgjësimi nuk është kryer i plotë, nuk është marrë shërbimi. Në këtë rast ritheksojmë domosdoshmërinë e një njësie që monitoron pagesat e kryera në funksion të shërbimit të marrë. Së fundmi, sjellim në vëmendje se referuar nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", krijuesi ose zotëruesi fillestar i mbetjeve (në këtë rast Bashkia Tiranë për territorin që administron), që transferon mbetjet te një tregtar ose person që kryen operacione trajtimi të mbetjeve, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, nuk çlirohet nga përgjegjësia për operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit të tyre. Pra pavarësisht se BT grumbullon dhe dorëzon te koncesionari mbetjet e gjeneruara, ajo mbetet përgjegjëse dhe zotëruesi i tyre deri në finalizimin edhe të operacioneve të rikuperimit ose asgjësimit të tyre.
2. Lidhur me saktësimin e bërë në pikën 2 mbi vonesat e dorëzimit të vend depozitimit, sqarojmë se, shkaqet e vonesave që paraqisni qendrojnë, por konstatimi mbetet, pasi në kontratë janë parashikuar afate dhe nuk janë përmbushur. Për këtë rast theksojmë edhe përcaktimet e vazhdueshme në kontratë sipas të cilave, AK dhe Koncesionari duhet vazhdimisht të bashkëpunojnë pikërisht për mos tej kalimin e afateve të përcaktuara.

Gjetje nga auditimi:

23. Dorëzimi i vend-depozitimit të mbetjeve nga Bashkia Tiranë (BT), është kryer me procesverbalin nr. 44121, datë 07.12.2017, pra rreth 3 muaj me vonesë;
24. Deri në mesin e vitit 2020, pra 3 vite pas nënshkrimit të kontratës, nuk është bërë dorëzimi i shesheve apo parcelave të tjera plotësuese;
25. Autoriteti Kontraktor ka shkelur detyrimet e kontratës për mbështetjen dhe lehtësimin e procedurave të shpronësimit duke shkaktuar vonesa në finalizimin e këtij procesi, ku referuar VKM nr. 811, datë 26.12.2018, janë shpronësuar vetëm një pjesë e pronave të

dorëzuara sipas kërkesës nr. 60, datë 22.02.2018. Ky proces është finalizuar me tepër vonesë me VKM nr. 1154/2020;

26. Vonesat e shkaktuara nga AK në procesin e shpronësimit kanë sjellë edhe vonesa në zbardhjen e lejes së ndërtimit, e cila është lëshuar me Vendimin nr. 14, datë 17.05.2019 dhe ndryshuar me Vendimin nr. 52, datë 28.12.2020 të KKT;
27. Janë shkaktuar vonesa në fillimin e punimeve edhe si pasojë e mos dorëzimit të dokumentacionit të plotë për çështjen e shpronësimeve dhe lejeve të ndërtimit nga ana e Konkensionarit, referuar shkresës nr. 6390/5, datë 30.12.2019 të sektorit të shpronësimeve pranë MIE;
28. Njësia e Zbatimit të Projektit është ngritur me 3 muaj vonesë;
29. Me përjashtim të Loteve B dhe C, të gjithë Lotet e tjerë janë jashtë afateve të përfundimit të punimeve të përcaktuara në grafikun e punimeve;
30. Aneksi IX óForma e angazhimit mbi detyrimet e NjQVô, është nënshkruar pas një periudhe 7 mujore nga Bashkia Tiranë, ndërkohë nuk është nënshkruar nga Bashkitë e tjera, pjesë të qarkut;
31. Për shërbimin e depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve, vihet re se si pasojë e mos përfundimit të ndërtimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve, Konkensionari ende sot nuk ka trajtuar dhe asgjësuar asnjë sasi mbetjesh të marra në dorëzim. Pavarësisht mos kryerjes së procesit të trajtimit të mbetjeve, MIE ka vijuar të kryej pagesat e plota të tarifës për këtë shërbim si óTransfertes së Pakushtëzuarô për zërin e pastrimit të qytetit;

Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Tiranë është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/23, datë 25.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitô nga z. E. V. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Kapitulli mbi óPagesatô në kontratën bazë të këtij koncesioni, specifikon se tarifa e depozitimit të mbetjeve në këtë objekt është 29 Euro/ton, duke filluar nga dita efektive e kësaj kontrate. Kryerja e pagesave është bërë në përputhje me angazhimet kontraktore të marra nga AK në kontratën e koncesionit. Për sa kohë kemi të bëjmë me një marrëdhënie kontraktuale sipas të cilës janë marrë përsipër të drejta dhe detyrime, rrjedhimisht edhe angazhimet financiare janë parashikuar të shlyhen sipas saj (LOB).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga BT, sqarojmë se; vwrret pagesat po kryhen sipas kapitullit përkatës në kontratë, por për periudhën aktuale të kryerjes së auditimit koncesionari ende nuk ka ndërtuar veprën ndërtimore ose impiantin e djegies së mbetjeve, si procesi më i rëndësishëm i trajtimit dhe risia apo argumenti mbi të cilin është krijuar kjo marrëveshje koncesionare. Mbështetur në evidencat që subjektet e auditimit kanë vendosur në dispozicion, ende jemi në kushtet kur, BT për sasi të mbetjeve që ka depozituar pranë landfillit ndërtuar nga “I. E. B.V shpk” ka paguar periodikisht tarifën, por nuk është shërbyer plotësisht për shërbimin sipas kontratës, duke mos e kryer incinerimin.

32. Në planin e biznesit përcaktohet se kosto e projektit do të përballohet në vlerë të plotë nga kapitali i shoqërisë dhe nga burimet e brendshme të saj, pa patur nevojë që të merret një kredi bankare. Ndërkohë Konkensionari I. E. ka kërkuar financim nëpërmjet dy kontratave Kredie Afatgjatë dhe Afatmesme për vijimin e projektit;
33. Kreditë do të garantohen duke vënë në garanci të ardhurat që do të gjenerohen nga kontrata koncesionare në fjalë, ndërkohë që i vetmi burim të ardhurash për Konkensionarin aktualisht janë ato nga depozitimi i mbetjeve, pasi si pasojë e mos përfundimit të impiantit të trajtimit të tyre, ende nuk gjenerohen të ardhura nga shitja e energjisë;
34. Gjatë periudhës së auditimit u konstatua se NjZP nuk ka funksionuar e plotë për shkak të largimit të një anëtarit të Ministrisë së Mjedisit dhe prej kohësh ky institucion nuk ka marrë masa për zëvendësimi i tij, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga NjZP;

35. Aktualisht shpenzimet e kryera për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve, monitorohen nga MIE për shkak të detyrimit kontraktual që ka kjo e fundit, për të mbështetur financiarisht BT gjatë 4 viteve të para të operimit. Në përfundim të periudhës 4-vjeçare nuk është parashikuar asnjë strukturë e cila të monitorojë saktësinë dhe vërtetësinë e shpenzimeve që do të kryhen nga BT, në funksion të sasive të mbetjeve që do të depozitohen në landfill;
36. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në fazën e studim-fizibilitetit nuk ka negociuar me palën koncesionare tarifën që rëndon mbi buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe më pas në bashkitë e tjera të Qarkut të Tiranës. Kjo tarifë e paguar për 2018-2020 llogaritet në vlerë prej **3,234,124,798 lekë**, e cila ka dyfishuar shpenzimet e MIE si transferues i óTransfertës së Pakushtëzuarô, për zërin e pastrimit të qytetit;
37. Prej vitit 2018 deri aktualisht, prej MIE është paguar tarifa prej **29 euro/ton** mbetje urbane për incinerimin e mbetjeve për një shërbim jo i plotë, duke qenë se incineratori ende nuk është përfunduar si objekt industrial për djegien e mbetjeve urbane. Pavarësisht kësaj, pastrimit të qytetit të Tiranës prej 3,866,183,658 lekë për periudhën 2018-2020, depozitimi dhe incinerimi i tyre ka shtuar koston për buxhetin e shtetit edhe me 3,234,124,798 lekë të tjera për një shërbim ende të pa ekzekutuar përfundimisht.

Konkluzione:

12. Si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK ashtu edhe nga Konkensionari, janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit;
13. Edhe pas fillimit të punimeve, pjesa më e madhe e Lote-eve janë jashtë afateve të përcaktuara në Grafikon e Punimeve, si pasojë e të cilave ende nuk kemi në përdorim një impiant për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë. Për sa më lart, buxheti i shtetit prej 2 vitesh po parapaguan shërbimin e trajtimit të mbetjeve, i cili ende nuk kryhet;
14. Si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe mos vlerësimit të risqeve të mundshme mbi mundësitë e financimit të Konkensionarit, ekziston risku që kontrata e konkensionit në fjalë të hasë në vështirësi për vijimin e saj në rast se nuk do të arrijë të gjenerojë sasinë e nevojshme të të ardhurave të vëna në garanci për kredinë;
15. Për grupin e auditimit nuk është vënë në dispozicion asnjë procesverbal në të cilin faktohet negociimi i palëve të përfshira mbi barrën financiare të tarifës koncesionare prej 29 Euro/ton, për óNdërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend-depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik óI. E. B.V shpkô. Kjo tarifë ka rritur shpenzimet e buxhetit të shtetit, nga ku edhe analizat e studimit të fizibilitetit, nuk japin argumente të saktë dhe të qartë mbi përballimin e shtimit të kësaj koste për Bashkinë Tiranë në rolin e përfituesi kryesor dhe bashkitë e Qarkut Tiranë, nëse do të përfshihen, pavarësisht mos njoftimit të tyre në fazat e hershme të kontraktimit.

Rekomandime:

12. AK në bashkëpunim me NJZP, të marrin masa për nxitjen e Konkensionarit për avancimin e punimeve të cilat janë jashtë afateve të parashikuara në grafikonin e punimeve.

Menjëherë

13. AK të kërkojë nga Konkensionari një analizë të detajuar mbi vlerat e kredisë së përfituar dhe mënyrën e përdorimit dhe mbulimit të tyre, si dhe një analizë mbi nivelin e të ardhurave të parashikuara në vitet në vijim, për të marrë një farë garancie se mbulimi i kredisë nuk do të çenojë vijimin e kontratës.

Menjëherë

14. Autoriteti Kontraktor dhe NJZP të marrin masa që:

- Të ngrihet një grup pune i përbashkët për analizën e shkaqeve, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe marrjen e masave për likuidimet për punë të pakryer;

- Të nisin bisedimet së bashku me Koncesionarin me qëllim që, brenda kuadrit ligjor në fuqi, të shikohet mundësia e ngritjes së një grupi të përbashkët mes Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë dhe Koncesionarit, për të identifikuar, saktësuar dhe rakorduar mes tyre mbi pjesën e tarifë/ton që i takon veçmas procesit të incinerimit që ende nuk është kryer.

Menjëherë

Në lidhje me këtë rekomandim nga MIE është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/22, datë 21.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó nga znj. V. H. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në kushtet e një kontrate koncensionare të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit sot MTM dhe Koncesionarit, ku çmimi është i përcaktuar në të, për të garantuar sasinë minimale të mbetjeve urbane, në zbatim të Nenit 7.3, pika 7.3.2, diferenca e financimit që nuk mbulohet nga Bashkia Tiranë, miratohet me Ligjin e Buxhetit dhe kalon përmes MIE tek buxheti i Bashkisë Tiranë. Mënyra e shpërndarjes së fondeve bëhet nga Bashkia Tiranë, sipas sasisë së mbetjeve urbane të depozituara në landfill.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga MIE, sqarojmë se për grupin e auditimit, mekanizmi i kalimit të fondeve tek BT për ekzekutimin e pagesës për sasinë të mbetjeve, është i qartë, por rekomandimi i mësipërm i referohet mundësisë për negociim midis Bashkisë Tiranë dhe MTM në cilësinë e AK sot ju, për përdorimin e fondeve me eficiencë dhe efektivitet, referuar kryerjes së pagesës për shërbimin që realisht merret dhe ofrohet për qytetarët. Ndërkohë që jemi në kushtet që ky shërbim, djegia e plerave, nga viti 2018 deri aktualisht nuk është kryer, por është paguar sikur të ishte kryer. Si e tillë komenti juaj nuk merret në konsideratë për ndryshimin e rekomandimit.

Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Tiranë është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/23, datë 25.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitó nga z. E. V. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sipas parashikimeve kontraktuale BT nuk është palë në kontratën koncensionare, me qëllim negociimin e tarifës për depozitimin e mbetjeve. Ju bëjmë me dije se kontrata përcakton qartë rastet kur palët ulen për të negociuar, por sigurisht duke patur në vëmendje dhe ato që janë parimet e ligjit 125/2013 të ndryshuar, studimin e fizibilitetit, modelin financiar si dhe angazhimet e ndërmarra nga palët. Pjesë e këtij auditimi është edhe MIE e cila në tagrin e AK ka të drejtën të ftoj për rishikim Koncesionarin në lidhje me indikacionin në fjalë. Në kontratën koncensionare kap.7.2 Axxhustimi i çmimit/ton mbetje sipas inflacionit, pika 7.2.2 përcakton se ó...në çdo rast çmimi(tarifa) ton mbetje, pavarësisht ecurisë së inflacionit nuk do të jetë nën shifrën 29 euro/ton mbetje urbaneó

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga BT, sqarojmë se: axhustimi i çmimit përmendur në pikën 7.2.2 të kontratës është vetëm në kushtet e ndikimit nga inflacioni, ndërkohë që rekomandimi është rezultat i analizës së gjetjeve të auditimit, ku BT si pagues i tarifës koncensionare, përpara dhënies së pëlqimit për koncesionin duhet të njihej cilësisht me detyrimet koncensionare.

15. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për caktimin e anëtarit të saj përfaqësues në NjZP.

Menjëherë

16. AK dhe Bashkia Tiranë të marrin masa për ngritjen e një strukture e cila të monitorojë saktësinë e shpenzimeve të shërbimit që do të kryhen për koncesionarin nga BT në përfundim të periudhës 4-vjeçare, në funksion të sasive të mbetjeve që do të depozitohen në landfill.

Menjëherë

17. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të negociojnë termat kontraktuale të operatorëve ekonomikë të pastrimit në funksion të rialokimit të shpenzimeve për zërin ódepozitim i mbetjeve urbane në landfillô.

Brenda muajit Dhjetor 2022

Në lidhje me këtë rekomandim nga Bashkia Tiranë është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/23, datë 25.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitô nga z. E. V. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sqarojmë se detyrimet financiare të operatorëve të pastrimit përfundojnë më transportin e mbetjeve në landfill. Procesi i depozitimit të sasive të transportuara prej tyre në këtë objekt aktualisht mbulohet nga buxheti i BT dhe transfertat e QQ vënë në dispozicion për këtë proces për një periudhë kohore të caktuar. Kontratat e operatorëve të pastrimit nuk kanë pasur asnjëherë pjesë të tyre mbulimin e kostove të depozitimit të mbetjeve në landfill

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga BT, sqarojmë se: prej vitit 2018 kur koncesioni i Incineratorit të Tiranës si projekt ka filluar veprimtarinë e depozitimit të mbetjeve urbane, vlera financiare e BT për pastrimin e qytetit është dy fishuar, çka e bën pastrimin e qytetit zërin që rëndon më tëpër në taksapaguesit. Duke qenë se QQ do e mbështes BT vetëm për 4 vitet e para sipas kontratës, njëhërësh edhe mos përfshirja e BT në negocimin e tarifës e cila drejtëpërdrejtë është kosto e saj, grupi i auditimit rekomandon rishikimin e shumës financiare të kontratave më Operatorët e pastrimit , si një mundësi e përballimit të kostove të shtuara për zërin e mbetjeve urbane.

Në lidhje me projektraportin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1142/24, datë 31.01.2022 óMbi Projektraportin e Auditimitô nga znj. M. K. në cilësinë e Ministrit, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Përmbajtja e shkresës citon angazhimin e MTM për të marrë masat e nevojshme në vijimësi për zbatimin e akteve ligjore evidentuar nga grupi i auditimit si dhe gadishmërinë për të bashkëpunuar me institucionet e përfshira në fushën e mbetjeve për zbatimin e kuadrit ligjor të fushës. Ndër të tjera MTM shprehet se ndryshimi i përgjegjësisë së MTM për mbetjet si dhe transferimi i dokumentacionit dhe kontratës e përjashton MTM lidhur me nxitjen në avancimin e punimeve, marrjen e të dhënave në lidhje me kredinë e përfituar dhe nivelin e të ardhurave mbi situatën e saktësisë së shpenzimeve si dhe negocimin për termat kontraktuale të operatorëve ekonomikë të pastrimit në funksion të rialokimit të shpenzimeve të depozitimit të mbetjeve urbane në landfill.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga MTM, sqarojmë se: argumentimi dhe evidencat e gjetjeve dhe konkluzioneve që grupi i auditimit ka ofruar në materialin e raportit të auditimit, derivon nga fusha e përgjegjësisë së MTM për periudhën respektive në të cilën është vepruar për realizimin e kontratës koncesionare të incineratorit të Tiranës. Edhe pse fusha e përgjegjësisë sipas akteve të cituara më sipër ka kaluar në MIE si AK në vijimësi, strukturat përgjegjëse mbi të cilën atakohet MTM sipas përgjegjësisë të njohura në aktet regullative, i referohet çështjeve të mjedisit dhe respektimit të standardeve kombëtare e ndërkombëtare të fushës. Si e tillë komentet tuaja nuk ofrojnë evidenca shtesë për ndryshimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të hartuara në raportin e auditimit.

5. PËRMBLEDHJA

MESAZHI I AUDITIMIT⁶¹

⁶¹ Shkronja ólô në pikën 10 të nenit 31 në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017, i ndryshuar, të Kryetarit të KLSH-së dhe Manuali i Auditimit të Performancës, miratuar me Vendimin nr.78, datë 30.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

Drejtimet dhe politikat e Ministrisë së Mjedisit (sot MTM) në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane. Procedura e planifikimit të projektit të Incineratorit të Tiranës ka mungesa dhe paqartësi në lidhje me propozimin paraprak të ardhur në ministri nga shoqëria dhe konfirmimin e miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Financave (sot MFE).

Mungesa e vendimmarrjes së MFE në cilësinë e vlerësuesit dhe miratuesit paraprakisht të gjithë projektit koncesionar dhe PPP, nga pikëpamja e implikimeve financiare për incineratorin e Tiranës, shpreh në mënyrë të qartë paqëndrueshmërinë dhe ndërmarrjen e angazhimeve publike që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe efektivitetin e projektit. Mungesa e përgjigjeve zyrtare dhe dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e së cilave lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar, ka devijuar procesin e rregullt të këtij angazhimi duke sjellë mungesë eficiense dhe identifikim të risqeve potenciale, konkretisht ai fiskal dhe financiar lidhur me kostot e shpronësimeve dhe përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike. Mungesa e dakordësisë me shkrim e bashkive të tjera të Qarkut Tiranë përveç Bashkisë Tiranë, provokon në të ardhmen kosto financiare për këto bashki, mos përfshirja e të cilave mbi këtë argument do të sjellë mungesë efektiviteti për realizimin e projektit të Incineratorit të Tiranës. Mos dakortësimi i tarifës prej 29 euro/ton së depozitimit në landfill, ka dyfishuar shpenzimet për Bashkinë Tiranë, të paguara nga MIE si transferues i óTransfertës së Pakushtëzuarô, për zërin e pastrimit të qytetit. Aktualisht çmimi i paguar 29 euro/ton nuk është çmimi real i shërbimit që kryhet, pasi kjo tarifë përfshin edhe incinerimin e mbetjeve proces i cili nuk është kryer deri më sot. Procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncension nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimet ligjore. Janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit, si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK ashtu edhe nga Koncensionari.

Për Pyetjen: 1. A ka qenë efektive procedura e vendimmarrjes?

Për Pyetjen: 1.1 A ka qenë i mbështetur në kuadrin rregullator dhe strategjik planifikimi i këtij investimi?

Duke qenë se kontrata koncesionare për ndërtimin e këtij objekti është nënshkruar nga Ministria e Mjedisit (si Autoritet Kontraktues), ndërsa paralelisht ushtrohej edhe projekti për minimizimin e mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve, mund të konkludohet se drejtimet dhe politikat e këtij institucioni në lidhje me reduktimin e mbetjeve kanë qenë të pa fokusuara dhe jo në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe evropiane.

Duke marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e audituara mund të konkludohet se procedura e planifikimit të këtij projekti ka mungesa dhe paqartësi në lidhje me propozimin paraprak të ardhur në ministri dhe konfirmimin e miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të legjislacionit të kohës.

Për sa më sipër, vihet re që procesi i studimit dhe planifikimit të këtij investimi është bërë i pa mbështetur në politikat strategjike të promovuara nga Ministria e Mjedisit. Për përzgjedhjen e procedurës koncesionare, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka zhvilluar një analizë të plotë dhe faktoriale, ku të merreshin parasysh skenarë dhe rezultate shteruese, për të përcaktuar llojin e procedurës që duhej përdorur për ndërtimin e Incineratorit të Tiranës. Nisur nga këto konstatime grupi i auditimit ka rekomanduar që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njësitë e Qeverisjes vendore të marrin masa për reduktimin e sasisë së mbetjeve nëpërmjet promovimit të 3R-ve (reduktim, ripërdorim dhe riciklim), diferencimin e mbetjeve në burim dhe progresin në lidhje me objektivat e riciklimit, në përputhje me synimet strategjike të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesave / standardeve të Bashkimit Europian, duke mos trajtuar si zgjidhje me përparësi impiantet e incenerimit apo metodat e tjera në fund të hierarkisë së mbetjeve. Njëherësh Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zhvillimin e procedurave në vazhdimësi, të kryej analiza të detajuara duke

vlerësuar faktorët e riskut dhe studiuar procedurën më të përshtatshme, për ndërtimin e veprave infrastrukturore në fushën e mjedisit.

Për Pyetjen: 1.2 A ka qenë i dakordësuar nga të gjitha palët e përfshira realizimi i këtij investimi?

Vijimi i procedurës mbi Incineratorin e Tiranës në mungesë të vendimmarrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e vlerësuesit dhe miratuesit paraprakisht të gjitha projekteve koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale, pavarësisht nga modeli i parashikuar i koncesionit/PPP dhe mënyra në të cilën ato janë nisur, d.m.th., propozim i kërkuar apo i pakërkuar, konkretisht edhe në propozimin e operatori ekonomik ól. E. B.Vô shpk, për incineratorin e Tiranës, shpreh në mënyrë eksplicite papërballueshmërinë dhe/ose paqëndrueshmërinë si edhe ndërrmarjen e angazhimeve publike që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe efektivitetin e projektit. Mungesa e një procesi konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit për nisma sensitive dhe impakt tek qytetarët, ka sjellë refuzimin e mendimit njëherësh aprovimit të projektit koncesionar për dhënien me koncesion ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.Vô shpk nga Ministria e Drejtësisë. Mos respektimi i rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat, ku duhej të ishte vënë në dispozicion informacioni dhe studimi i fizibilitetit, nuk evidenton qartësisht dhe zyrtarisht nëse projekti përmbush kërkesat ligjore dhe nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor. Mungesa e dakordësisë së institucioneve qendrore, fushë veprimtaria e të cilave lidhet ngushtësisht me objektin e projektit koncesionar, devijon procesin e rregullt të miratimit mbi këto nisma duke sjellë mungesë eficiense dhe identifikim të risqeve potencialë. MTM ka vazhduar procedurën mbi projektin koncesionar të Incineratorit të Tiranës, duke anashkaluar koston e shpronësimit të sipërfaqes së nevojshme për ndërtimin e veprës së projektit rreth 478,800 m² tokë arrë të vlerësuara me çmimin prej 448 lekë/m² që përbën kosto prej 214,502,400 lekë, vlerë e cila nuk është parashikuar në tavanet buxhetore për mbështetjen e projektit nga buxheti i shtetit. Nisur nga këto konstatime grupi i auditimit ka rekomanduar që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në funksion të paraqitjes për miratim të projekteve koncesionare që sigurojnë përballueshmëri financiare, qëndrueshmërinë e borxhit publik, implikime fiskale dhe risk të moderuar, të propozojë në Këshillin e Ministrave ndryshimet ligjore referuar VKM 575/2013 óPër miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/pppô, i ndryshuar, nenin 21, pika 3, nga pikëpamja e miratimit të projekteve të tilla strategjike dhe financiarisht të larta, jo apriori vetëm si shkak i tejkalime të afateve vendimmarrëse. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për këtë projekt dhe në vijimësi, të sigurojë për ministrinë e linjës dhe grupet e interesit transparencë të plotë të analizës së ndikimit mjedisor dhe social, në funksion të investimit të planifikuar, si pjesë e studimit të fizibilitetit, për të bërë të mundur një vlerësim paraprak të aspekteve të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së propozimit, që identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë, por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht; si dhe aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti. ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

Për Pyetjen: 2. A janë marrë masat e nevojshme për të siguruar eficiencën e projektit?

Për Pyetjen: 2.1 A është zbatuar procedura e duhur e konkurrimit për këtë investim?

Procedura konkurruese për dhënien e këtij projekti me koncension, nuk është kryer në përputhje me parimet e transparencës dhe përcaktimet ligjore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion

rezultoi se Studimi i Fizibilitetit nuk përmban nënshkrimin e të gjithë anëtarëve të komisionit dhe konkretisht mungon nënshkrimi i këtij dokumenti nga përfaqësuesja e MIE dhe nga një prej përfaqësuesve të BT. Në Njoftimin e Kontratës nuk identifikohen, vlera e parashikuar e kontratës koncesionare; afati i fundit për dorëzimin e ofertave; adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat; gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat; koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave; kriteret për përjashtimin e ofertuesve; kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla; lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin; kriteret për dhënien e kontratës; emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës. Procedura konkurruese nuk gjendet as në Sistemin Elektronik të Prokurimit, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme shkruese dhe komunikimeve elektronike me MTM dhe APP. Nisur nga këto konstatime grupi i auditimit ka rekomanduar që AK të marrë masa të menjëhershme të dokumentojë dhe ruajë në përputhje me parashikimet ligjore të gjithë procedurën e konkurrimit, si fizike ashtu edhe elektronike. Për këtë, KVO përkatëse, në momentin e largimit të bëjnë mbylljen dhe arkivimin e procedurave në SPE për të cilat janë përgjegjës, si dhe të bëjnë dorëzimet e nevojshme pranë grupeve të punës për këtë qëllim.

Për Pyetjen: 2.2 A janë përmbushur detyrimet e kontratës koncesionare deri në momentin e auditimit?

Si pasojë e veprimeve dhe mos veprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK ashtu edhe nga Konkensionari, janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit. Edhe pas fillimit të punimeve, pjesa më e madhe e Lote-eve janë jashtë afateve të përcaktuara në Grafikon e Punimeve, si pasojë e të cilave ende nuk kemi në përdorim një impiant për trajtimin e mbetjeve dhe prodhimin e energjisë. Për sa më lart, buxheti i shtetit prej 2 vitesh po parapaguan shërbimin e trajtimit të mbetjeve, i cili ende nuk kryhet. Si pasojë e mos planifikimit të saktë dhe mos vlerësimit të risqeve të mundshme mbi mundësitë e financimit të Konkensionarit, ekziston risku që kontrata e konkensionit në fjalë të hasë në vështirësi për vijimin e saj në rast se nuk do të arrijë të gjenerojë sasinë e nevojshme të të ardhurave të vëna në garanci për kredinë. Për grupin e auditimit nuk është vënë në dispozicion asnjë procesverbal në të cilin faktohet negociimi i palëve të përfshira mbi barrën financiare të tarifës koncesionare prej 29 Euro/ton, për òNdërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitimi i vend-depozitimeve ekzistuese Tiranë, propozuar nga operatori ekonomik ól. E. B.V shpkò. Kjo tarifë ka rritur shpenzimet e buxhetit të shtetit, nga ku edhe analizat e studimit të fizibilitetit, nuk japin argumente të saktë dhe të qartë mbi përballimin e shtimit të kostos së pastrimit për Bashkinë Tiranë në rolin e përfituesit kryesor dhe bashkitë e Qarkut Tiranë, nëse do të përfshihen, pavarësisht mos njoftimit të tyre në fazat e hershme të kontraktimit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në fazën e studim-fizibilitetit nuk ka negociuar me palën koncesionare tarifën që rëndon mbi buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe më pas në bashkitë e tjera të Qarkut të Tiranës. Kjo tarifë e paguar për 2018-2020 llogaritet në vlerë prej 3,234,124,798 lekë, e cila ka dyfishuar shpenzimet e Bashkisë Tiranë dhe MIE si transferues i óTransferts së Pakushtëzuarò, për zërin e pastrimit të qytetit. Prej vitit 2018 deri aktualisht, prej MIE është paguar tarifa prej **29 euro/ton** mbetje urbane për incinerimin e mbetjeve për një shërbim ende të pakryer, duke qenë se incineratori ende nuk është përfunduar si objekt industrial për djegien e mbetjeve urbane. Pavarësisht kostos së pastrimit të qytetit të Tiranës prej 3,866,183,658 lekë për periudhën 2018-2020, depozitimi dhe incinerimi i tyre ka shtuar koston për buxhetin e shtetit edhe me 3,234,124,798 lekë të tjera për një shërbim ende të pa përfunduar. Nisur nga këto konstatime grupi i auditimit ka rekomanduar që Autoriteti Kontraktor dhe Bashkia e Tiranës të marrin masa që: 1) Të ngrihet një grup pune i përbashkët për analizën e shkaqeve, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe marrjen e masave për likuidimet për punë të pakryer;

2)Të nisin bisedimet së bashku me Koncesionarin me qëllim që, brenda kuadrit ligjor në fuqi, të shikohet mundësia e ngritjes së një grupi të përbashkët mes Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë dhe Koncesionarit, për të identifikuar, saktësuar dhe rakorduar mes tyre mbi pjesën e tarifë/ton që i takon veçmas procesit të incinerimit që ende nuk është kryer.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të negociojnë termat kontraktualë të operatorëve ekonomikë të pastrimit në funksion të rialokimit të shpenzimeve për zërin ódepozitim i mbetjeve urbane në landfillô.

6. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE

1. M. B., Përgjegjëse e grupit të auditimit;
2. R. K., Anëtare;
3. K. A., Anëtar;
4. A. Gj., Anëtar.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

A. J.